

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5933
E hënë, 18 nëntor 2019
çmimi 0.40 €

Shteti duhet ta trajtojë
me seriozitet sektorin
privat **FAQE 8-9**



FLET PËR "EPOKËN E RE", NASIM HARADINAJ **FAQE 4-5**



FTESAT E SPECIALES KANË PËR QËLLIM NJOLLOSJEN E UÇK-së

Nënkryetari i OVL-UÇK-së, Nasim Haradinaj, ka thënë se Gjykata Speciale me ftesat e shumta për intervistim për ish-ushtarët e UÇK-së ka dalë jashtë kontrollit. Në këtë

intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Haradinaj ka thënë se këto ftesa kanë për qëllim njollosjen e luftës së UÇK-së e jo pastrimin e saj. Ai ka thënë se këto ftesa ia kujtojnë thirrjet

e kohës së Rrahman Morinës. Sipas tij, numri i madh i ftesave të Gjykatës Speciale tregon se kjo gjykatë nuk ka prova të mjaftueshme për të ngritur aktakuza

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

OBELISKU I MIRËNJOHJES QË I MUNGON KOSOVËS

Shkruan:
Bedri ISLAMI

F. 10-11



AKTUALE



KURTI: NUK KA SHKËMBIM TË TERRITOREVE PA GJAKDERDHJE

F. 3

ZBULOHEN DY PLLAKA PËRKUJTIMORE TË UÇK-së NË KRYEQYTET F. 4

PAKOJA E LIGJEVE NGA AGJENDA EVROPIANE KTHEHET NË PIKËN ZERO F. 7

EKONOMI

TABE KRASNIQI, SHEMBULL I NJË FERMERE TË SUKSESSHME F. 8

DIASPORA KA ENERGJI DHE KAPITAL PËR INVESTIME NË VENDET SHQIPTARE F. 8

SPORT

HASANI: MUND TË FITOJMË MEDALJE NË 'TOKYO 2020' F. 20

Rinumërohen rreth 40 për qind e vendvotimeve **FAQE 3**



Kosova mbyll kualifikimet me humbje

"Dardanët" i mbyllën kualifikimet për Kampionatin Evropian "Euro 2020" me humbje. Kombëtarja e fuqishme botërore, Anglia, shënoi fitore me rezultat të thellë 0-4 në "Fadil Vokrri" kundër Kosovës. Kjo ishte humbja e parë e Kosovës në këto kualifikime dhe e para në stadiumin "Fadil Vokrri". Futbollistët e Bernard Challandesit në këto kualifikime grumbulluan 11 pikë dhe përfunduan në pozitën e tretë në Grupin A



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Diplomati i ShBA-së vlerëson Metën

Tiranë, 17 nëntor - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, është takuar të dielën në Tiranë me diplomatit e lartë të ShBA-së, ambasadorin e posaçëm për liritë fetare, Sam Brownback.

Në një mesazh në Twitter, ambasadori i ShBA-së shprehet se ndjehet i nderuar që është takuar sot me kreun e shtetit shqiptar.

Takimi mes kreut të shtetit dhe diplomatit të ShBA-së vjen në kohën kur kryeministri Edi Rama

dhe zyrtarë të tjerë të profilit më të ulët në PS thonë se qëndrimet e kreut të shtetit për Gjykatën Kushtetuese janë kundër ShBA-së dhe BE-së.

Pas takimit me ambasadorin, presidenti Meta shkroi në rrjetet sociale, se "ShBA-ja është gjithmonë një kampion i lirisë dhe drejtësisë. Zoti e bekoftë miqësinë shqiptaro-amerikane!"

Konferenca ndërkombëtare, do të zhvillohet sot (e hënë) në Tiranë

nën kujdesin e presidentit të Republikës në bashkërendim me Departamentin amerikan të Shtetit me pjesëmarrjen e disa krerë shtetesh dhe parlamentesh nga rajoni, drejtues të bashkësive fetare në vend dhe nga rajoni, teologë, studiues dhe mjaft personalitete, të cilët do të diskutojnë mbi këtë temë të rëndësishme të frymëzuar edhe shembulli unik i bashkëjetesës, harmonisë dhe tolerancës fetare në Shqipëri.



Hooper: Marrëveshja Kosovë - Serbi ekziston, vetëm duhet zbatuar

Ish-zyrtari i Departamentit të Shtetit, James Hooper, thotë se duke pasur parasysh rezultatit e zgjedhjeve në Kosovë dhe zgjedhjet e ardhshme që do të mbahen në Serbi, unë mendoj se me të vërtetë ka shumë gjasa që ata të arrijnë një marrëveshje, madje besoj se praktikisht ata tashmë e kanë një marrëveshje, por vështirësia është te zbatimi i saj

Uashington, 17 nëntor - Ish-zyrtari i Departamentit të Shtetit dhe analisti James Hooper, deklaroi, në një intervistë për "Zërin e Amerikës", se një marrëveshje Kosovë - Serbi ekziston, por vështirësia është te zbatimi i saj. Hooper, i cili ka përvojë në negociatat diplomatike dhe në çështjet e Ballkanit, u shpreh se nuk mund të arrihet një marrëveshje gjithëpërfshirëse në mes të Kosovës dhe Serbisë pa shkëmbime territoriale. "Duke pasur parasysh rezultatit e zgjedhjeve në Kosovë dhe duke pasur parasysh zgjedhjet e ardhshme që do të mbahen në

Serbi, unë mendoj se me të vërtetë ka shumë gjasa që ata të arrijnë një marrëveshje. Madje besoj se praktikisht ata tashmë e kanë një marrëveshje", tha Hooper.

Por gazetari i VOA-s shprehet se nuk dihet asnjë detaj prej një pakti të tillë. Hooper thotë se nuk është tamam ashtu. "Unë në fakt mendoj se shumë nga detajet dolën, disa prej tyre edhe të pasakta. Dhe kosovarët kurrë nuk patën shansin të votojnë për këtë marrëveshje, të vendosnin për këtë marrëveshje. Nuk ka pse të përsërisim gjithë historinë e asaj që ndodhi. Por unë mendoj



se presidenti Thaçi kishte rënë dakord që dialogu të rifillonte pa kushte.

Dhe unë mendoj se ishte një veprim shumë i arsyeshëm për të ecur përpara, që të kemi një marrëveshje gjithëpërfshirëse, sepse nëse nuk lëvizin drejt një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse, ekziston rreziku që dritarja e mundësisë të mbyllet dhe, nëse kjo ndodh, nuk do të ketë një marrëveshje gjithëpërfshirëse për një kohë të pacaktuar", u shpreh zyrtari amerikan.

Hooper shtoi më tej se vështirësia më e madhe do të jetë për Albin Kurti, i cili shihet si dikush që ka marrë një pozicion të linjës së ashpër. Ai do të zbulojë se në fakt ka tashmë një marrëveshje dhe se nuk do të jetë në gjendje t'i ndryshojë këto kushte. Nuk bëhet fjalë thjesht të kërkohet që Serbia të japë më shumë. Kjo do të ishte më e thjeshta. Në fakt serbët mund të thonë që kosovarët duhet të japin më shumë. Kjo ndodh gjithmonë në negociata, është shprehur Hooper.

PD-ja do të marrë pjesë në tryezën e reformës zgjedhore

TIRANË, 17 NËNTOR - Partia Demokratike i thotë po tryezës së OSBE-së për reformën zgjedhore, e cila do të organizohet nesër (e martë).

Burime nga selia blu, konfirmuan për "Top Channel" se Partia Demokratike do të marrë pjesë në nivel teknik, në tryezën e diskutimit, e cila do të ketë në fokus

financimin e partive politike. "Në parim, kemi shprehur gatishmërinë për të qenë prezentë, po presim të njëjtimin me agjendën e takimit, tha një zyrtar i lartë i PD-së.

Në tryezën e OSBE-së, e cila nuk do të jetë e hapur për mediet, pritet të ketë diskutime nga ekspertë të ndryshëm zgjedhorë mbi temën e takimit si dhe për-

faqësues të komisionit parlamentar. Ky është takimi i dytë i organizuar nga prania e OSBE-së në kuadër të reformës zgjedhore, ku puna për të po vijohet e ndarë.

Kryemadhi takon kongresistët Joe Willson dhe Jim Costa

TIRANË, 17 NËNTOR - Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integritim (LSI), Monika Kryemadhi, në vijim të takimeve në Kongresin e ShBA-së zhvilloi takime edhe me kongresistët Joe Willson dhe Jim Costa.

Joe Wilson përfaqësues i South Carolinës ishte shumë i interesuar dhe tepër i vëmendshëm

për zhvillimet në Shqipëri. Gjatë diskutimit mjaft impresionues me të, ai shprehu gatishmërinë për të nxitur dhe intensifikuar dukshëm rritjen e vëmendjes së Kongresit të ShBA-së drejt Shqipërisë, rritjen e intensifikimin e mëtejshëm të partneritetit strategjik me Shqipërinë dhe rolin e vendin e veçantë të

saj si mbështetësja më e spikatur e politikave të ShBA-së për rajonin tonë.

Fryma e të gjithë takimeve mbresëlënëse në Kongres dhe Senat ishte rikonfigurimi i një mbështetje sa më të madhe për Shqipërinë përmes një prezence sa më aktive të ShBA-së.



Rinumërimi i votave në QNR ka vazhduar edhe të dielën

Rinumërohen rreth 40 për qind e vendvotimeve

Deri të dielën pasdite janë rinumëruar rreth 40 për qind e vendvotimeve të kërkuara nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP). Derisa ka vazhduar ky proces, subjektet politike kanë vazhduar polemikat rreth rinumërimit të votave. Sipas tyre, zgjatja e këtij procesi po dëmton rëndësinë e zgjedhjeve të parakohshme të 6 tetorit



EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 17 NËNTOR - Në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ka vazhduar edhe të dielën rinumërimi i mbi 1 400 vendvotimeve të urdhëruara nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP). Zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valmir Elezi, ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se gjatë kësaj dite janë rinumëruar rreth 40 për qind e këtyre votave. "Deri të dielën në orën 16:00 janë rinumëruar 499 vendvotime apo rreth 36 për qind", ka thënë Elezi.

Derisa në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve po vazhdon rinumërimi i votave, disa subjekte politike kanë vazhduar ta shprehin skepticizmin e tyre rreth këtij procesi. Kryetarja e Alternativës, Mimoza Kusari-Lila, ka bërë

me dije se zvarritja e procesit të rinumërimit të votave po sjell dyshime dhe skepticizëm për rezultatin e zgjedhjeve.

Kusari-Lila në një intervistë për gazetën "Epoka e re", e cila është botuar të shtunën, ka thënë se stërzgjatja e procesit zgjedhor po dëmton kredibilitetin e zgjedhjeve të 6 tetorit. Sipas saj, në këtë mënyrë po krijohet bindja për mundësinë e devijimit të vullnetit të qytetarëve. "Absolutisht po. Zgjatja e këtij procesi nuk sjell kredibilitet, por dyshime dhe skepticizëm për rezultatin që mund të pasojë nga ky proces", ka thënë Kusari-Lila. Megjithatë, ajo ka treguar se Alternativa është që asnjë vote të mos i humbet vlera. "Si Alternativë jemi për atë që asnjë qytetari të Kosovës të mos i humbet vota dhe secila votë të numërohet dhe të vihet në konsideratë. Gjithashtu, besojmë dhe shpresojmë se vullneti i

qytetarëve të Kosovës, i shprehur më 6 tetor, nuk do të devijohet nga pazaret e mundshme politike", është shprehur ajo.

Vendimi i PZAP-it për rinumërimin e mbi 1 400 kutive të votimit dhe vendimi i Gjykatës Supreme për t'i larguar votat e ardhura nga Serbia nga rezultati përfundimtar i zgjedhjeve të 6 tetorit ka bërë që koalicioni Nisma-AKR-PD përfundimisht të jetë pjesë e Kuvendit. Këto vendime kanë nxitur reagimet e Lëvizjes Vetëvendosje (LV), e cila tani mbetet në Kuvend me 3 mandate më pak. Sipas LV-së, vendimet e organeve të pavaru-

ra gjyqësore për zgjedhjet e 6 tetorit kanë qenë të ndikuara politikisht.

Reagimeve të LV-së i është përgjigjur edhe ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, tash kryetar i Këshillit Kombëtar të Nismës Socialdemokrate, Jakup Krasniqi, duke thënë se subjekti që përfaqëson nuk e ka problem qëndrimin në opozitë. "Gjuha që përdor partia politike duke qenë në opozitë nuk mund të përdoret duke qenë para një qeverisje të mundshme apo në qeverisje. Të qeverisurit nuk bëhet me gjuhën e sharjeve të opozitarizmit e as me metodat e zjarrvënive, por

me gjuhën e të qeverisurit me e për gjithë kombin (qytetarët), duke i pranuar edhe goditjet nga opozita, kur edhe ajo përdor armët që i ke përdorur duke qenë në opozitë. Për të mos ndodhur kjo, është mirë që drejtuesit e lartë të LV-së t'i marrin punët më shtruar e më me gjakftohtësi e përgjegjësi. Qeverisja e mirë është e mirë për çdo qytetar. Përndryshe, ne socialdemokratët ekzistimin në opozitë nuk e kemi problem, qafën nuk ia afrojmë askujt. Qëndrimi vertikal është tradita e jona! E kaluara është dëshmi", ka shkruar Krasniqi në llogarinë e vet në "Facebook".

Kurti: Nuk ka shkëmbim të territoreve pa gjakderdhje

PRISHTINË, 17 NËNTOR - Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje dhe kandidati për kryeministër, Abin Kurti, ka folur sërish rreth idesë për shkëmbim të territoreve. Ai ka hedhur poshtë idenë e shkëmbimit të territoreve, duke shtuar se prapa saj qëndron ideja e presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, për ta ndarë Kosovën. Kurti në një intervistë për "Pobjeda" të Podgoricës ka paralajmëruar se një konflikt i ri në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk do të mund të lokalizohet. "Pas dy grushtshteteve të dështuara, të Rusisë, në Mal të Zi dhe Maqedoninë Veriore, të kthehet nëpër dyer të mëdha tani përmes një konflikti të ri të armatosur midis Kosovës dhe Serbisë. Është e qartë se ky konflikt i ri i mundshëm nuk do të mund të lokalizohet. Sidomos kur, kundër Serbisë, shqiptarët veprojnë si një komb, jo vetëm si një shtet i brishtë i Kosovës",

ka thënë Kurti.

Më tutje, Kurti ka thënë se nuk ka shkëmbim territoreve pa gjakderdhje, duke shtuar se gjithmonë do të ketë shqiptarë dhe serbë në të dyja anët e kufirit. "Për më tepër, nëse realizohet ideja e Vuçiqit për korrigjimin e kufirit etnik, fitoni një problem të hapur dhe serioz në Bosnjë dhe Hercegovinë. Pse? Sepse ideja e korrigjimit është një term racist, i cili në mënyrë të pashmangshme na çon në konflikte të reja etnike. Nuk ka shkëmbim territori pa gjakderdhje. Gjithmonë do të ketë shqiptarë dhe serbë në të dyja anët e kufirit. Prandaj, pranimi i demarkacionit po, por jo shkëmbimi i territorit", është shprehur ai. Ndërsa duke folur për dialogun me Serbinë, Kurti ka thënë se aktualisht nuk ka nevojë të përshpejtohen negociatat në mes të Beogradit dhe Prishtinës, duke shtuar se ai



vetë ta drejtojë ekipin negociator të Kosovës si kryeministër, ku do të përfshihen edhe anëtarët e qeverisë, opozitës dhe ekspertët të pavarur.

"Serbia i ka borxh Kosovës për

agresion dhe okupim. Na ka borxh kompensimin e dëmeve të luftës, fondin pensional dhe kursimet e qytetarëve në banka të cilat i mori. Kurrë nuk i kthej artefaktet e trashëgimisë sonë

kulturore. Kurrë nuk i dorëzoi të dyshuarit për krime lufte. Pra, le të fillojmë me kërkesat tona, e të shohim se çfarë Serbia do të na ofrojë", është shprehur Kurti.

Flet për "Epokën e re", Nasim Haradinaj

Ftesat e Speciales kanë për



Nënkryetari i OVL-UÇK-së, Nasim Haradinaj, ka thënë se Gjykata Speciale me ftesat e shumta për intervistim për ish-ushtarët e UÇK-së ka dalë jashtë kontrollit. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Haradinaj ka thënë se këto ftesa kanë për qëllim njollosjen e luftës së UÇK-së e jo pastrimin e saj. Ai ka thënë se këto ftesa ia kujtojnë thirrjet e kohës së Rrahman Morinës. Sipas tij, numri i madh i ftesave të Gjykatës Speciale tregon se kjo gjykatë nuk ka prova të mjaftueshme për të ngritur aktakuza

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 17 NËNTOR - Nënkryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Nasim Haradinaj, është shprehur i befasuar me numrin e madh të ftesave të Gjykatës Speciale për

ish-pjesëtarët e UÇK-së. Ai ka thënë se kjo po bëhet për ta njollosur luftën e pastër të UÇK-së. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Haradinaj ka treguar se nuk kanë pritur një numër kaq të madh të ftesave. "Shumë individë që po e marrin ftesën nga Specialja po sillen

sikur janë duke shkuar në Hagë për ta pastruar luftën e UÇK-së. Këto ftesa, për mendimin tim, nuk kanë për qëllim ta bëjnë pastrimin e UÇK-së, apo ta dëshmojnë luftën e pastër e të drejtë të UÇK-së, por këto ftesa po bëhen për ta denigruar luftën dhe dinjitetin e UÇK-së. Pra,

ftesat e Speciales po bëhen për ta njollosur UÇK-në", ka thënë Haradinaj. Ai ka deklaruar se ftesat e shumta të Speciales po ia kujtojnë kohën e Rrahman Morinës. "Me këto ftesa, për mendimin tim, shihet që e ka humbur kontrollin. Këto ftesa po ma çojnë mallin e atyre thirrjeve në kohën e Rrahman Morinës që kanë qenë blanko, kurse këta hetuesit e regjimit vetëm e vendosnin emrin e personit", ka thënë ai. Nënkryetari i OVL-UÇK-së ka treguar arsyet se pse po ndodh ky numër i madh i ftesave të Gjykatës Speciale. Sipas Haradinajt, po shihet se kjo gjykatë nuk ka prova të mjaftueshme për të ngritur

aktakuza. "Ndoshta ky fluks i madh i ftesave është për arsye se ata ende nuk kanë arritur të mbledhin materiale të nevojshme për të ngritur aktakuza apo diçka të tillë. Kohët e fundit kanë filluar të thirrjin edhe të dyshuar. Në fillim thërrisnin vetëm në cilësinë e dëshmitarit. Ftesat kanë qenë banale. Ka pasur ftesë dëshmitar i dyshuar. Nuk ka askund në botë një term të tillë juridik", është shprehur ai.

Haradinaj ka kritikuar ata që po iu gëzohen ftesave të Speciales. Sipas tij, një gjë e tillë është mjaft e rëndë. "Fatkeqësisht, një pjesë e njerëzve po iu gëzohen këtyre ftesave të gjykatës. Ata njerëz qenë hidhëruar edhe kur e patëm

Zbulohen dy pllaka përkujtimore të UÇK-së në kryeqytet


PRISHTINË, 17 NËNTOR - Në Prishtinë të dielën është bërë zbulimi i dy pllakave përkujtimore të Shtabit të Qendror të UÇK-së. Njëra pllakë përkujtimore është zbuluar në rrugën "Agim Ramadani", tjetra në lagjen "Bregun e Diellit". Kryetari i Organizatës së Veteranëve të UÇK-së, Hysni Gucati, ka deklaruar se vendosja e këtyre dy pllakave është bërë për të treguar se në këto dy vende janë

kryer organizimet e para të aksioneve të pjesëtarëve të UÇK-së. Sipas tij, në këto vende gjatë viteve 1994-1997 janë marrë vendime të mëdha për vendin. "Sot kemi bërë zbulimin e dy pllakave të UÇK-së. Këto pllaka janë bërë për arsye se në vitet '94-'97 ka pasur një shtab qendror të UÇK-së, kanë punuar celularat e para të Ushtrisë Çlirimtare, janë marrë vendime të mëdha për

vendin si dhe janë marrë vendime të mëdha për kryerjen e aksioneve të UÇK-së. Organizata e Veteranëve të Luftës e ka ndjerë për obligim që t'i vendosë këto dy pllaka", ka thënë Gucati. Në këtë ngjarje kanë marrë pjesë gjenerali Rexhep Selimi, Nait Hasani, Bislim Zogaj, Zahir Pajaziti, Lahi Ibrahimaj të cilët kanë qenë protagonistë të UÇK-së.



qëllim njollosjen e UÇK-së



njerëz që nuk kanë qenë fare në UÇK. OVL-UÇK nuk e njeh këtë gjykatë, sepse është një gjykatë e padrejtë. Megjithatë, ne kemi bërë apel që veteranët të bashkëpunojnë me këtë institucion që të mos japim rast për arrestime.

"Epoka e re": Pas këtyre ftesave ka pasur reagime të ndryshme. Si i keni parë këto reagime?

Haradinaj: Fatkeqësisht, një pjesë e njerëzve po iu gëzohen këtyre ftesave të gjykatës. Ata njerëz qenë hidhëruar edhe kur e patëm nisur luftën. Këtyre qysh atëherë iu ka mbetur hatri. Tani ndoshta kanë arsyeje të gëzohen! Sepse, në njëfarë forme, pas 20 vjetëve iu ka ardhur koha të hakmerren. Sot kjo gjykatë po ua bënë qefin atyre që ne para 20 e sa viteve ua kemi prishur qefin. Dikush nuk ka pasur dëshirë të ketë luftë, ka pasur qejf t'i kenë ende këtu dashamirët e tyre. Po më vjen keq që ata po e shprehin haptazi këtë. Në njëfarë mënyre ata sikur janë duke e pritur edhe kthimin e serbëve këtu sepse t'u gëzohesh ftesave të Speciales për ish-ushtarët e UÇK-së është e rëndë. T'i gëzohet dikush kësaj është e barabartë sikur t'i gëzohet kthimit të Serbisë në Kosovë. Pastaj, edhe shumë individë që po e marrin ftesën nga Specialja po sillen sikur janë duke shkuar në Hagë për ta pastruar luftën e UÇK-së. Këto ftesa, për mendimin tim, nuk kanë për qëllim ta bëjnë pastrimin e UÇK-së, apo ta dëshmojnë luftën e pastër e të drejtë të UÇK-së, por këto ftesa po bëhen për ta denigruar luftën dhe dinjitetin e UÇK-së. Pra, ftesat e Speciales po bëhen për ta njollosë UÇK-në.

"Epoka e re": OVL-UÇK-ja, a ka ndonjë numër të saktë se sa veteranë janë ftuar nga Specialja, dhe a e keni pritur një numër kaq të madh të ftesave?

Haradinaj: Nuk e di numrin e saktë, sepse lajmërimi për ftesë në OVL-UÇK është në baza vullnetare. Por ajo që dihet është se janë qindra ftesa deri më tani që Specialja ka dërguar për ish-pjesëtarët dhe eprorët e lartë të UÇK-së. Normalisht që nuk kemi pritur numër kaq të madh të këtyre ftesave. Ne kemi pritur ftesa sa për ta arsyetuar ata punën e tyre, por jo deri në këtë masë.

"Epoka e re": Pse mendoni se po ndodh ky numër kaq i madh i ftesave?

Haradinaj: Ndoshta ky fluks i madh i ftesave është për arsyeje se ata ende nuk kanë arritur të mbledhin materiale të nevojshme për të ngritur aktakuza apo diçka të tillë. Kohët e fundit kanë filluar të thirrën edhe të dyshuar. Në fillim thërritnin vetëm në cilësinë e dëshmitarit. Ftesat kanë

qenë banale. Ka pasur ftesë dëshmitar i dyshuar. Nuk ka askund në botë një term të tillë juridik. Serioziteti i kësaj gjykate shihet në këto ftesa, ku teksti është i njëjtë. Këto ftesa ma çojnë mallin e ftesave të Rrahman Morinës, kur ishte izolimi, që ishin blanko dhe veç i mbushnin emrat këta agjentët nëpër komuna të ndryshme për njerëzit që ata i shihnin si të dyshimtë. Teksti i ftesave është i njëjtë si për të dyshuarin, si për dëshmitarin. Pastaj, luajnë me data, një herë në ftesë iu caktohet një datë, pastaj përmes telefonit u tregojnë se u është shtyrë data. Në njëfarë mënyrë kjo gjykatë s'po e trajton Kosovën si shtet. Është duke bërë hajgare me ne.

"Epoka e re": Është paralajmëruar se OVL-UÇK-ja mund të organizojë

protesta për shkak të këtyre ftesave. Kur do të vendosni për këtë çështje?

Haradinaj: Ashtu siç jemi marrë vesh me kryetarin, besoj se të mërkurën do të thirret një mbledhje e Kryesisë së OVL-UÇK-së dhe në të do të vendoset. Sepse ne nuk marrim vendime individuale. Vendimet për protesta i merr kryesia. Aty mund të ketë mendime të ndryshme, por në fund fiton mendimi të cilin e përkrah shumica. Ne duhet ta shqyrtojmë se a na konvenon protesta në gjendjen e brishtë politike që e kemi. Pastaj, për kënd do të protestojmë, për ata që vet e kanë votuar Gjykatën Speciale, apo vetëm për këtë pjesën që tash janë viktimat të atyre që e kanë votuar në Kuvend këtë gjykatë.

"Epoka e re": Po ashtu, është folur se mund të ketë edhe arrestime. A keni ndonjë informatë se kur mund të ndodhin ato dhe pse?

Haradinaj: Ne e kemi pasur një informatë nga disa avokatë të huaj, gjermanë, italianë dhe anglezë, se mund të fillojnë arrestimet. Por, se kur mund të fillojnë, s'e dimë. Së pari ne urojmë që të mos ketë arrestime, së dyti nuk po kuptojnë pse duhet të arrestohen derisa të gjithë po i përgjigjen pozitivisht thirrjes dhe po bashkëpunojnë me këtë gjykatë. Ushtarët e UÇK-së po bashkëpunojnë me këtë gjykatë edhe pse nuk e njohin mënyrën e saj se si është ngritur. Ne nuk jemi kundër hetimeve të krimeve të luftës, por duam që krimet e luftës të hetohen në përgjithësi. E dihet se kush ka bërë dhe ka pasur mundësi të bëjë krime gjatë luftës në Kosovë.



Heroi Luan Haradinaj, po të ishte gjallë, do ta festonte ditëlindjen e 46

PRISHTINË, 17 TETOR (ER) - Të dielën është shënuar ditëlindja e 46 e heroit Luan Haradinaj, vëllait të kryeministrit në detyrë, Ramush Haradinaj, i cili kishte rënë në njëren prej betejave të para të UÇK-së kundër forcave pushtuese serbe, më 6 maj të vitit 1997, në kufirin shqiptaro-shqiptar. Në lidhje me këtë, Ramush Haradinaj

përmes një postimi llogarinë e vet në "Facebook" ka përkujtuar ditëlindjen e Luanit. Haradinaj ka thënë se po të ishte gjallë, Luani do ta festonte ditëlindjen e 46. "Luan, urime ditëlindja! Para 23 vjetësh ke rënë për Atdhe, si 23 vjeçar. Sot Luani i ri është në rreshtin e ushtrisë sonë për dëshmi se lufta për liri vazhdon

përjetësisht. I paharruar kujtimi për ty!" Trupi i Luan Haradinajt kishte pushuar në Vlanë të Shqipërisë deri në çlirimin e Kosovës. Pas çlirimit, trupi i tij është riarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit në vendlindjen e tij, në Glogjan të Rekës, ku prehet i qetë, së bashku me 20 dëshmorët e vendlindjes.

nisur luftën. Këtyre qysh atëherë iu ka mbetur hatri. Tani ndoshta kanë arsyeje të gëzohen! Sepse, në njëfarë forme, pas 20 vjetëve iu ka ardhur koha të hakmerren", është shprehur Haradinaj.

"Epoka e re": Z. Haradinaj, ftesat e Gjykatës Speciale për ish-pjesëtarët e UÇK-së nuk kanë të ndalur. Cili është qëndrimi i OVL-UÇK-së për këtë trend të ftesave?

Haradinaj: Si duket kjo gjykatë po ngutet ta shtojë punën dhe të tregojë se po punon diçka. Dihet që fondet që iu kanë ndarë kësaj gjykate nuk janë të vogla. Pastaj, është duke ardhur fundi i afatit që e ka për të vepruar, që është viti 2020. Siç dihet, kjo gjykatë deri më tani ka qenë shumë pasive, jo për të mirën tonë, por se nuk ka pasur materiale. Me këto ftesa, për mendimin tim, shihet që e ka humbur kontrollin. Këto ftesa po ma çojnë mallin e atyre thirrjeve në kohën e Rrahman Morinës që kanë qenë blanko, kurse këta hetuesit e regjimit vetëm e vendosin emrin e personit. Tani kjo gjykatë po thirr njerëz që kanë qenë jashtë UÇK-së. E ka thirrur ministrin e Drejtësisë, Abelard Tahirin. E ka thirrur Driton Lajçin e Zyrës Koordinuese, që është zyrë e tyre. Pastaj, ka thirrur edhe

Ka filluar rregullimi i parkut në fshatin Marali

MALISHEVË, 17 NËNTOR (ER) - Në fshatin Marali të Malishevës ka filluar rregullimi i hapësirës në qendër të këtij fshati, përkatësisht rregullimi i parkut në fshat, në hapësirën ku është vendosur edhe një lapidar. Në fillimin e punimeve për rregullimin e parkut ishin të pranishëm nënkryetari i komunës, Hajdin Berisha dhe drejtori i Urbanizmit, Islam Vrenezi, të cilët janë takuar edhe me përfaqësuesit e fshatit dhe banorët. "Ndërtimi i parkut në fshatin Marali është pjesë e investimeve komunale në kuadër të realizimit të projek-

teve kapitale për këtë vit dhe në të njëjtën kohë ka qenë edhe kërkesë e banorëve që ta kenë këtë hapësirë të rregulluar", tha nënkryetari Berisha, i cili edhe i ka uruar banorët. Edhe banorët e Maralisë janë shprehur të kënaqur me realizimin e kërkesës së tyre pasi, përveç rregullimit të hapësirës, parku luan rol të madh edhe në ruajtjen e hapësirës publike. Sipas drejtorit të Drejtorisë së Urbanizmit, Islam Vrenezi, rregullimi i parkut do të kushtojë rreth 25 mijë euro dhe financohet nga buxheti i Komunës së Malishevës.



Komuna e Pejës dënon sulmin fizik ndaj drejtorit Leotrim Murtezaj dhe zyrtarëve të tjerë



PEJË, 17 NËNTOR (ER) - Persona ende në arratisje kanë sulmuar fizikisht drejtorin e Inspeksionit në Komunën e Pejës, Leotrim Murtezaj dhe zyrtarët e kësaj drejtorie, duke tentuar t'i pengojnë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare dhe t'i frikësojnë që të kujdesen për rend dhe rregull ashtu siç e kërkon ligji.

Kryetari i Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri dhe Këshilli i Drejtorëve e kanë dënuar këtë akt qyqar dhe kanë

kërkuar nga organet e rendit që t'i kapin autorët dhe t'i dorëzojnë para drejtësisë. "Ne të gjithë jemi në mbështetje të drejtorit të inspeksionit dhe të zyrtarëve të tjerë. Të gjithë duhet ta kuptojnë mirë se ne nuk i frikësohem askujt dhe nuk ndalemi në rrugën tonë demokratike për realizimin e objektivave tona zhvillimore. Populli na ka dhënë besimin dhe ne u mbesim besnik premtimeve tona", është bërë me dije në reagimin e Komunës së Pejës.

Haziri: Gjilanit do t'i shtohet kapaciteti i ujit të pijshëm për 25 litra për sekondë

GJILAN, 17 NËNTOR - "Lajmi i mirë është se për pak ditë Gjilanit do t'i shtohet kapaciteti i ujit të pijshëm për 25 litra për sekondë nga shpimi i tre puseve të kazerma e Ushtrisë së Kosovës", kështu ka bërë me dije kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri. Ai ka thënë se në javën e ardhshme do të kalohet në lagjen Fidanishte për hapjen e

puseve të reja për edhe 25 litra për sekondë më shumë. "Kjo është zgjidhje për situatën emergjente, ndërkaq zgjidhja afatgjatë parashihet të bëhet përmes Lumit Krivareka dhe ndërtimit të pendës së Llapushnicës. Kurseni ju lutem, sepse uji është jetë!", ka shkruar Haziri në llogarinë e vet në "Facebook".



Bëhet këndi i ri i lodrave për fëmijët pranë Fakultetit Teknik

PRISHTINË, 17 NËNTOR (ER) - Komuna e Prishtinës është duke vazhduar investimet në projekte të ndryshme. Sipas një njoftimi të Komunës së Prishtinës, tashmë është bërë këndi i ri i lodrave pranë Fakultetit Teknik.

"Këndi i ri i lodrave pranë Fakultetit Teknik mund të jetë vendi ku mund të kaloni kohë me fëmijët këtë fundjavë të nëntorit plot diell", është bërë me dije në njoftimin e komunës.

Pakoja e ligjeve nga agjenda evropiane kthehet në pikën zero



PRISHTINË, 17 NËNTOR - Me shpërndarjen e legjislativës së gjashtë të Kuvendit të Kosovës, në procedurë pa u miratuar kanë mbetur 43 ligje. Në mesin e tyre janë edhe ligjet të cilat janë kërkuar nga Bashkimi Evropian e që kanë për qëllim edhe përafrimin e Kosovës me BE-në. Meqë përbërja e kaluar e Kuvendit nuk ka arritur t'i miratojë këto ligje, të gjitha kthehen në pikën zero, por disa prej tyre, sidomos ato që ndërlidhen me kriteret dhe standardet e BE-së, konsiderohen se do të jenë prioritet i punës së institucioneve të reja që do të formohen si rezultat i zgjedhjeve parlamentare të 6

tetorit.

Deputetët e ardhshëm të partive politike nga Lëvizja Vetëvendosje dhe Partia Demokratike e Kosovës kanë mendime të ndryshme për atë se si duhet të veprohet me ligjet të cilat kanë mbetur në proces. Arbërie Nagavci nga Lëvizja Vetëvendosje ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se shumë nga ligjet do të rishikohen dhe do të kthehen në pikën zero. "Proceduralisht të gjitha kthehen në pikën zero. Tani me fillimin e punës së qeverisë, varësisht prej ligjeve që janë me prioritet, duhet të fillohet menjëherë puna pa ndalesa dhe pa

hezitim. Ndërsa në rastet kur ka një bazë të mirë, sigurisht se mund të merret parasysh, të rishikohet, mandej të vazhdohet me finalizimin e tyre. Por, në aspektin formal të gjitha kthehen në pikën zero", ka thënë Nagavci. Kurse Blerta Deliu-Kodra, deputete e ardhshme nga Partia Demokratike e Kosovës, e cila me gjasë do të jetë në opozitë, konsideron se projektligjet të cilat kanë shkuar në Kuvendin e Kosovës nga qeveria tashmë në largim dhe të cilat janë pjesë e agjendës së reformave të Bashkimit Evropian duhet të miratohen pa vonesa. "Të gjitha

ato ligje të cilat e kanë kaluar leximin e parë natyrisht se janë në procedurat e Kuvendit dhe i mbetet legjislativës së re që ta miratojë pakon e këtyre projektligjeve të cilat natyrisht kërkojnë një nguti më të madhe për shkak të përafrimit tonë me Bashkimin Evropian. Natyrisht se janë procedurat brenda Kuvendit të cilat parashohin që projektligjet të cilat kanë kaluar leximin e parë t'i miratojmë në leximin e dytë", është shprehur Beliu-Kodra. Ndryshe, sipas Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, të gjitha çështjet të cilat janë proceduar në Kuvend dhe që nuk kanë

përfunduar deri në fund të punës së legjislativës së gjashtë konsiderohen si të përfunduara dhe nuk vlejnë për legjislativën e ardhshme.

Agnesa Haxhiu nga Instituti Demokratik i Kosovës, që monitoron punën e Kuvendit, ka thënë se të gjitha ligjet të cilat kanë qenë në procedurë, pavarësisht se në cilën fazë, ato nuk vlejnë për legjislativën e re apo qeverinë e ardhshme. "Sa iu takon projektligjeve që kanë qenë në procedurë, konsiderohen të përfunduara aty dhe nuk mund të kthehen në legjislativën e re, në përjashtim prej rastit kur qeveria e re ose Kuvendi i shih si të arsyeshme e i parashih në programin legjislativ dhe i sjell në Kuvend, por jo domosdo duhet me qenë ato ligje apo ato amendamente të cilat janë propozuar nga komisionet të cilat kanë qenë në legjislativën e gjashtë", është shprehur Haxhiu. Disa prej ligjeve të cilat rrjedhin nga agjenda për reforma evropiane janë: Kodi i ri penal, Ligji për arsimin e lartë, Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale e të tjera. Zyrtarët ndërkombëtarë në Kosovë kanë inkurajuar institucionet dhe vetë Kuvendin e Kosovës për miratimin e pakos së ligjeve për Agjendën Evropiane të Reformave, respektivisht ligjet që lidhen me reformat në sistemin e drejtësisë. Përbërja e kaluar e Kuvendit të Kosovës në vazhdimësi është kritikuar për joefikasitet dhe mosangazhim të duhur për mosrealizimin e planeve të punës. Përfaqësuesit ndërkombëtarë në Kosovë, por edhe organizatat joqeveritare që kanë monitoruar punën e këtij institucioni, kanë deklaruar se jo që nuk janë miratuar ligjet sipas planit të paraparë, por edhe ato që janë miratuar nuk janë mbikëqyruar nëse po zbatohen apo jo.

Rreth 35 për qind e lindjeve në QKUK me prerje cezariane

PRISHTINË, 17 NËNTOR (ER) - Nga frika e dhimbjeve gjatë lindjes, shumë gra zgjedhin që foshnjën e tyre në jetë ta sjellin përmes lindjes me prerje cezariane. E numri i këtyre lindjeve është në rritje. Vetëm nga janari i këtij viti deri më tani janë kryer rreth 34 për qind e lindjeve me prerje cezariane. Këto të dhëna i ka bërë me dije për "EkonomiaOnline", Astrit Gashi, gjinekolo-obstetër në Klinikën e Gjinekologjisë në QKUK. "Frekuenca e lindjeve me prerje cezariane është rritur në Kosovë. Në Kosovë aktualisht 34 për qind e lindjeve janë bërë me prerje cezariane, që i bie se që çdo e treta grua lind me prerje cezari-

ane", ka thënë Gashi.

Gjinekologu Gashi ka thënë se në krahasim me vitin e kaluar numri i lindjeve me prerje cezariane ka shënuar një rritje për një për qind. "Vitin e kaluar afërsisht shkon në 2 655 lindje me prerje cezariane, që i bie diku 34.2 për qind", ka thënë ai, duke shtuar se lindjet me prerje cezariane janë një trend global. Gashi ka treguar se, sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), rekomandohet që vetëm 15 për qind e lindjeve mund të kryhen me prerje cezariane, ndërsa 85 për qind të tjera janë të tjera, që mund të përfundojnë me rrugë natyrale me një fëmijë dhe nënë të shëndetshme.



Flet për "Epokën e re", Jusuf Azemi

Shteti duhet ta trajtojë me



Kryetari i Sindikatës së Sektorit Privat, Jusuf Azemi, ka kërkuar nga institucionet vendore që ta trajtojnë me seriozitet pozitën e sektorit privat. Azemi në këtë intervistë dhënë "Epokës së re" ka thënë se kushtet e pafavorshme në sektorin privat janë duke ndikuar që të rinjtë e Kosovës të orientohen kah Perëndimi. "Jemi të bindur se mbi 70 për qind e punëtorëve në sektorin privat qëllim përfundimtar e kanë ikjen nga Kosova pasi s'ka kushte të qëndrojnë këtu", ka deklaruar Azemi. Ai ka thënë se janë duke insistuar që paga minimale në sektorin privat të jetë 350 euro. Në këtë kontekst, Azemi ka bërë me dije se gjatë kësaj jave do të organizojnë protesta dhe, në rast se nuk merren parasysh kërkesat e tyre, do të futen në grevë

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 17 NËNTOR - Kryetari i Sindikatës së Sektorit Privat, Jusuf Azemi, ka thënë se qeverisjet e Kosovës nuk e kanë trajtuar asnjëherë me seriozitet sektorin privat. Ai në këtë intervistë për "Epokën e re" ka thënë se mostrajtimi me seriozitet i këtij sektori ka bërë që punëtorëve t'u shkelen të drejtat dhe të diskriminohen në paga. Azemi ka theksuar se mostrajtimi me seriozitetit i shtetit karshi sektorit privat ka ndikuar që të rinjtë e Kosovës të orientohen kah Perëndimi. "Punëtorët e sektorit privat nuk e kanë asnjë

shenjë të marrjes nën mbikëqyrje të institucioneve shtetërore dhe se gjendja e tyre vetëm po përkeqësohet. Prandaj, me këtë ritëm po zvogëlohet edhe numri i punëtorëve që punojnë në sektorin privat, pasi një pjesë e tyre bukur e madhe janë të orientuar që të dalin në përmendim, kurse pjesa tjetër i marrin pagat 170-200 euro dhe kështu që s'kanë leverdi të punojnë për këto paga", ka thënë Azemi, duke shtuar se rreth 70 për qind e të rinjve në sektorin privat qëllim e kanë ikjen nga Kosova. "Është normale që në numrin e ikjeve të të rinjve kanë ndikuar edhe kushtet jo të mira në sektorin privat, pasi kjo kategori

nuk është trajtuar në mënyrë serioze dhe ato pak përfitime që i kanë punëtorët e sektorit privat nuk janë zbatuar fare. Dhe kjo është arsyeja për të cilën ne nuk kemi krijuar kushtet elementare për qëndrim të punëtorëve në Kosovë dhe për një jetë stabile sociale të tyre. Për këtë jemi të bindur se mbi 70 për qind e punëtorëve në sektorin privat qëllim përfundimtar e kanë ikjen nga Kosova, pasi s'kanë kushte minimale që të qëndrojnë këtu", ka deklaruar Azemi.

"Epoka e re": Z. Azemi, në çfarë gjendje janë punëtorët e sektorit privat, meqë kemi reagime të

shumta për paga dhe orare të papërshtatshme?

Azemi: Punëtorët e sektorit privat nuk e kanë asnjë shenjë të marrjes nën mbikëqyrje të institucioneve shtetërore dhe se gjendja e tyre vetëm po përkeqësohet. Prandaj, me këtë ritëm po zvogëlohet edhe numri i punëtorëve që punojnë në sektorin privat, pasi një pjesë e tyre bukur e madhe janë të orientuar që të dalin në Perëndim, kurse pjesa tjetër vazhdojnë të punojnë dhe marrin paga 170-200 euro në muaj dhe s'kanë leverdi të punojnë për këto paga.

"Epoka e re": E përmendet orientimin e të rinjve në Perëndim. A është kjo si pasojë e kushteve jo të mira të punës në sektorin privat?

Azemi: Është më se normale që në numrin e ikjeve të të rinjve kanë ndikuar edhe kushtet jo të mira në sektorin privat, pasi kjo kategori nuk është trajtuar në mënyrë serioze dhe ato pak përfitime që i kanë punëtorët e sektorit privat nuk janë zbatuar fare. Kjo është arsyeja për të cilën ne nuk kemi krijuar kushtet elementare për qëndrim të punëtorëve në Kosovë dhe për një jetë stabile sociale të tyre. Për këtë jemi të bindur se mbi 70 për qind e punëtorëve në

sektorin privat qëllim përfundimtar e kanë ikjen nga Kosova, pasi s'ka kushte minimale që të qëndrojnë këtu.

"Epoka e re": Megjithëkëtë, për thirrjet tuaja ka këndvështrime të ndryshme. Nuk mund t'u rritet paga minimale punëtorëve siç kërkonte ju, pasi nuk mund të interferohet në politika të bizneseve private.

Azemi: Në fakt, politika është ajo që ka ndërhyrë në sektorin privat, pasi që nga viti 2011 e deri më tani nuk ka ngritje edhe pse është e obliguar që deri në fund të vitit të llogaritet kosto jetësore dhe paga minimale të rritet. Por, përkundër kësaj, që nga viti 2011 nuk kemi ngritje dhe për këtë dikush duhet të japë llogari. Tani mund të them se kemi kaluar nga një fazë për të cilën dihet se ne si BSPK jemi marrë vesh që paga minimale të jetë 250 euro. Tani e pranojmë këtë pagë prej 250 eurosh, por duhet të jetë 350 euro, përndryshe pronarët e kompanive nuk do ta kenë shërbimin tonë siç e kanë pasur më herët.

"Epoka e re": Z. Azemi, për pushimin e lehonisë, çfarë pritjesh keni, meqë kjo çështje ka

seriozitet sektorin privat



shkaku kyç që e kemi këtë gjendje, por mendojmë se kjo çështje është për shkak të moskujdesit të veçantë nga qeveria ndaj sektori privat.

"Epoka e re": Keni paralajmëruar protesta dhe greva nëse nuk do të ketë rritje të pagës minimale prej 350 eurosh. Mund të na thoni se në çfarë formati keni planifikuar t'i organizoni këto forma të reagimit?

Azemi: Ne kemi paraparë që të martën dhe të mërkurën të kemi nga një orë protestë. Mandej të enjten do të mblihdemi me sindikata dhe të shohim se a ka ndonjë lëvizje pozitive. Në rast se nuk do të ketë ndonjë lëvizje, atëherë do të futemi në grevë pas javës që vjen.

"Epoka e re": Sa punëtorë do t'i bashkëngjiten protestës dhe grevës që jeni duke i paralajmëruar?

Azemi: Ne vetëm në tri institucione që parashohim protesta dhe greva kemi rreth 400 anëtarë. Pra, janë punëtorët që kryejnë shërbime për Komunën e Prishtinës përmes kompanisë private, në Rektorat dhe në Qendrën e Studentëve.

"Epoka e re": Me Komunën e Prishtinës është arritur një marrëveshje për rritje të pagave prej katër përqindësh. A do ta pranoni këtë ofertë?

Azemi: Ne kemi e pranuar atë rritje, por kërkesa ka datuar nga viti 2011 dhe Komuna e Prishtinës ka nxjerrë vendim dhe këto janë çështje të ndara. Komuna e ka kryer vetëm një kërkesë tonën. Kërkesa tjetër është që në minimum paga të jetë 350 euro, kurse rritja është bërë vetëm 4 përqind e që do të paguhet në mënyrë retroaktive nga 1 janari 2020, pra një pjesë e kërkesës sonë është kryer, kurse pjesa tjetër ende.

"Epoka e re": Ju, po ashtu, jeni duke kërkuar që këta punëtorë të kthehen në shërbyes civilë. A mendoni se do t'ia dilni?

Azemi: Po të ishte një qeveri dhe udhëheqje serioze jo që do të ishte e mundur, por tani do të kryhej. Besoj se këta njerëz që i kanë bërë këto veprime do t'i ndjekin penalisht, pasi janë të privatizuar në mënyrë të jashtëligjshme dhe ne do t'i ndjekim të gjithë hapat.

Tabë Krasniqi, shembull i një fermere të suksesshme

PRISHTINË, 17 NËNTOR (ER) - Sektori i bujqësisë është bërë atraktiv edhe për femrat të cilat me angazhimin e tyre në veprimtari bujqësore po tregohen mjaft të suksesshme. Një ndër to është edhe Tabë Krasniqi, e cila ka më shumë se 10 vjet që merret me mbarëshkrimin e lopëve qumështore. Veprimtarinë e saj blegtorale ajo e zhvillon në fshatin Vitomiricë të Pejës, ku menaxhon një fermë të lopëve me rreth 80 krerë lopë qumështore. "Ferma jonë merret kryesisht me rritjen e lopëve qumështore. Kemi diku 80 krerë lopë. Veprimtarinë në këtë fermë e kam nisur para 10 vjetëve", ka treguar blegtorja Krasniqi, duke treguar se në këtë veprimtari ajo ka të punësuar katër persona.

Dita e një blegtojeje asnjëherë nuk është rutinë për shkak të sfidave që ka kjo punë. Tabë Krasniqi, përkundër shumë sfidave,

ia ka dalë mbanë kësaj pune. "Çdo biznes i ka ato vështirësitë e veta, por duhet me qenë këmbëngulës që t'i arrish qëllimet. Kjo veprimtari sjell edhe përfitime, e krahas kësaj, ka edhe vështirësi", ka thënë Krasniqi. Ajo ka thënë se punën në sektorin e blegtorisë më mirë e kryen një grua sesa një mashkull. Veprimtarinë blegtorale ajo planifikon që ta zgjerojë edhe më tej, duke e rritur numrin e lopëve në fermën e saj.

Mbështetje për investimet në fermën e saj, fermerja Krasniqi ka marrë edhe nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR). "Kjo stallë është rinovuar përmes mbështetjes së MBPZHR-së me grantin investiv prej 100 mijë eurosh, ku vlera e mbështetjes së ministrisë në këtë grant ka qenë 60 përqind, ndërsa vetë financimi ka qenë 40 përqind por, krahas kësaj,

investime në fermë kërkohen prapë, pasi që mungon edhe dhoma e qumështit", ka thënë ajo. Përveç blegtorisë, Krasniqi merret edhe me kultivimin e disa kulturave bujqësore, siç janë gruri dhe misri, ku falë angazhimit të saj dhe mbështetjes së Ministrisë së Bujqësisë, rezultatet në këtë fermë nuk po mungojnë. Nga kjo veprimtari bujqësore kjo familje po gjeneron të ardhura të kënaqshme si dhe ka arritur të punësojë edhe persona të tjerë. "Ky biznes është komercial, nuk është biznes familjar. Nga të ardhurat që siguroj këtu mbaj katër fëmijë dhe burrin. Sidomos përmes kësaj veprimtarie kam arritur t'i mbuloj shpenzimet për shkollimin e tyre", ka thënë ajo. Ndryshe, MBPZHR-ja po vazhdon mbështetjen e sektorit të blegtorisë si përmes granteve investive, po ashtu edhe përmes subvencioneve.



mbetur në procedurë për shkak të shpërndarjes së Kuvendit?

Azemi: Ligji i Lehonisë, siç është i miratuar, parashihet që punëtorët për pushim të lehonisë tre muaj t'i paguajë shteti dhe gjashtë muaj të paguhet nga pronarët e kompanive. Por, me kërkesën tonë, e që ligji nuk ka mundur ende të amendamentohet, kemi kërkuar që gjashtëmuajorin e parë ta paguajë shteti dhe tremujorin tjetër pronari i kompanisë.

"Epoka e re": Për mospërfillje të të drejtave të punëtorëve, a është shkaktar edhe numri i vogël i inspektorëve?

Azemi: Ne nuk konsiderojmë se numri i vogël i inspektorëve është

Diaspora ka energji dhe kapital për investime në vendet shqiptare

PRISHTINË, 17 NËNTOR (ER) - Kryetari i nderit në Rrjetin Global, Lazim Destani, ka thënë se shpreson se në të ardhmen të ketë më shumë investime nga diaspora në viset shqiptare. Sipas tij, diaspora ka energji dhe kapacitete për investime të tilla, veçse duhet të ketë më shumë siguri për investitorët. Megjithatë, ai ka

thënë se janë duke ardhur ditë të mira për investime të mërgatës në rajon, konkretisht në vendet me shumicë shqiptare. Lazim Destani nga Rrjeti Global ka pranuar se ka disa mangësi në të bërit biznes, por ka thënë se po punohet në vazhdimësi për t'i kaluar pengesat në mënyrë që të ketë më shumë investime të diasporës

në vendet e origjinës. Biznesmeni nga Maqedonia ka porositur secilin që të ketë besim në kapitalin dhe investimin e tij. Sipas tij, një klimë e mirë për investime i bënë të gjithë më të besueshëm dhe më të qartë, duke rritur kështu edhe numrin e investimeve në vende të ndryshme./Ksp/



OBELISKU I MIRËNJOHJES QË I MUNGON KOSOVËS



Shkruan: Bedri ISLAMI

Do të jetë e vështirë, jo vetëm për brezin tonë, por edhe për gjeneratat që do të vijnë, më shumë për këto të fundit, që liria e Kosovës, e gjithë ajo që ndodhi në fundshekullin e shkuar, të perceptohet pa praninë, jo vetëm politike e diplomatike, por shumë më të gjerë, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Do të jetë e vështirë të perceptohet se si ndodhi kjo prani e pazakontë në një trevë ballkanike, e një shteti të largët, Amerikës, duke krijuar një precedent të pazakontë shtetëror dhe të jashtëzakonshëm politik, krijimin e një shteti të dytë shqiptar, një ëndërr e hershme, që, në shumë breza kishte kushtuar pafund mund, gjak e jetë njerëzore. Ajo që, në vitin e largët 1913, në fillimin e shekullit të XX, ishte një ndërprerje e për-bashkësisë shqiptare, do të merrte një përmasë të mrekullueshme në fundin e këtij shekulli, duke bërë të prekshme, të jetësueshme dhe reale një pamundësi brezash.

Si ndodhi e gjithë kjo? Ishte vetëm në një ditë, në një çast, apo vazhdë e një përpjekje të gjatë, të vazhdueshme, këmbëngulëse, ku humbjet kishin qenë të rënda edhe për një komb të madh, e aq më tepër një përgjysmim shteti, i cili, me gjithë ëndërrën e tij për mëvetësi dhe bashkim me pjesën amë, kishte mbetur i ngujuar në robërinë e tij? E bëri atë vetëm një grup njerëzish apo ishin përpjekje të pazakonta, të të gjithë shqiptarëve, nga secila trevë a bashkësi?

Si u bë e mundur, për here të parë, në një përmasë të tillë, bashkimi i shqiptarëve, pa dallim vendi ku ndodheshin, bindje politike që kishin, vizioni që bartin, gjeneratave që u takonin, punëve që bënin? Si ndodhi që presidenti amerikan, Klinton, ndër mori hapin e madh historik të ndërhyrjes në një shtet sovran, i cili kishte përdhosur sovranitetin dhe dinjitetin e një shteti-ëndërr; si u bë e mundur që një bashkësi e madhe dhe e fuqishme shtetesh, më e madhja në historinë njerëzore, ndër to edhe miqtë shekullarë të shtetit serb, të bashkoheshin dhe të ndërmerrenin aktin e parë, të

fuqishëm ushtarak dhe të menduar politikisht, i pari i këtij lloji, në këto përmasa, në një vend tjetër, aq më tepër evropian, e, për më shumë, në një trevë ballkanike, e cilësuar si fuqi baruti, ku serbët kishin qenë gjithë me furrat e zjarrit në duar?

Çdo gjë e ka fillimin e saj. Ka edhe një moment kur ndryshon boshti i gjërave dhe nis një epokë e re, tejet e ëndërruar, rrugë e mundimshme, shpesh herë e përgjakur. Ka një ditë që, edhe pse e heshtur, e mbajtur brenda vetes, gjen shpalljen e saj si ndër më të veçantat, megjithëse për shumë kohë ka qenë një e panjohur e madhe. Ajo mund të jetë një ditë lirie, e cila tërheq pas vetes shumë ngjarje, zhvillime, mbresa, përjetime dhe, si çdo e tillë, edhe mbetet në memorien e një kombi. Në përpjekjet e pashembullta të shqiptarëve, sidomos të shqiptarëve të Kosovës, ka një ditë të tillë, të heshtur, por e pazakontë. Si çdo ditë e parë drejt lirisë.

AJO ISHTE DITA E PARË E LIRISË SË KOSOVËS

Në majin e vitit 1998 ndodhi një ngjarje e cila, më shumë se shumëçka tjetër, shpejtoi një proces që kishte nisur të lëvizte, por që nuk dihej ende kahu i lëvizjes së tij. Në Zvicër, në një heshtje të plotë dhe pa patur një përgatitje të mëhershme, do të zhvillohej takimi i parë mes zotit Holbrook dhe tre përfaqësuesve të Drejtorisë Politike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ata, të tre, ishin ndër figurat e larta drejtuese të Lëvizjes Popullore të Kosovës, strukturë politike, e cila, në vitin 1993, në Mbledhjen e saj IV të Përgjithshme, në shtëpinë e Brajshorëve, në mesin e Prishtinës, në klandestinitet të thellë, mori Vendimin për krijimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Për shumë kohë ky takim me zotin Holbrook, do të mbahej brenda vetes, ai nuk do të shpallej, por frytet e tij do të ishin të një rëndësie të jashtëzakonshme.

Si ndodhi? Siç dihet, në fillimin e shfaqjes publike të vëmendjes së ShBA në trajtimin e UÇK-së, ka pasur disa probleme, paqartësi dhe moskuptime, sidomos në qëndrimin e zotit Gelbard, pasi ai, fillimisht, kishte informacion jo të plotë dhe të gabuar lidhur me Lëvizjen Çlirimtare. Kemi qenë të bindur se mekanizma të informuar mirë në ShBA, mes tyre edhe lobi shqiptaro-amerikan, me të cilin ishin vendosur lidhje që në fillimin e vitit

1997, njerëzit e përgjegjshëm në Kosovë dhe jashtë saj, me të cilët zoti Gelbard ka pasur më vonë kontakte, kanë bindur atë se ndaj UÇK-së dhe të ardhmes së Kosovës, duhet të kishte një qasje tjetër.

Më vonë, nga zoti Gelbard është kërkuar një takim informues dhe u synua që takimi të jetë i fshehtë, të mos ketë rrjedhje informacioni, por pastaj ata vetë e bënë publik, ata deklaruan publikisht se administrata amerikane ishte në lidhje me UÇK-në, dhe kjo ishte një nismë e mekanizmave shtetërorë të ShBA-ve. Pikërisht, pas deklarimit të parë, jo favorizues dhe të përkohshëm, ndaj luftës çlirimtare, ka një impenjim të fuqishëm, do të thosha, të pazakontë të lobit shqiptar në ShBA, për të krijuar një mendim tjetër, mbështetës dhe përkrahës ndaj luftës që po niste në Kosovë. Përfaqësuesit e qeverisë amerikane kërkuar që të organizohej takimi i parë në Gjenevë, pikërisht me zotin Gelbard dhe të tjerë, dhe në këtë takim janë trajtuar të gjitha problemet politike dhe ato të luftës. Si të thuash, janë hapur të gjitha letrat, që nga gjendja politike në Kosovë, qëndrimet e subjekteve të veçanta, raportet e tyre me UÇK-në, shtrirja e saj, koncepti për luftën, ekzistenca e krahut politik të rezistencës së armatosur, lidhjet e lëvizjes çlirimtare me figura të ndriçuara të shqiptarëve në ShBA, etj. Nga ana e zotit Gelbard, por edhe nga takimet e zhvilluara në Tiranë,

përfaqësuesit amerikanë e kanë bërë të qartë se ato nuk e përkrahin terrorizmin, se UÇK-ja nuk guxon të bëjë veprime terroriste ndaj civilëve, se ajo nuk përkrah asnjë lëvizje, e cila merret me kontrabandën e armëve, drogës, se nuk duhej të kishte asnjë lidhje me vendet islamike, sidomos me lëvizje fundamentaliste dhe, si nuk është pritur, është kërkuar prej UÇK-së që të mos e trazonjë situatën në Maqedoni, ku asaj kohe shtrihet Zona e Dytë Operative e UÇK-së. Pikërisht në këtë kohë, jo papritmas dhe jo pa nisma të tjera diplomatike, për të pasur një nivel më të lartë në takimet e diplomatëve të njohur amerikanë me UÇK-në, vjen takimi me zotin Holbrook.

Në Zvicër, në ato ditë, zhvillohej Forumi Botëror për Ekonominë, në të cilin merrte pjesë edhe kryeministri i Shqipërisë, zoti Fatos Nano. Gjatë pjesëmarrjes në këtë takim tradicional, zoti Holbrooke i kërkoi zotit Nano që ky të ndërhyjë për të takuar


përfaqësuesit e UÇK-së në Perëndim.

Deri asaj dite kishte pasur shumë paqartësi dhe një mjegull mbi atë se çfarë përfaqësonin forcat e rreshtuara në radhët e gueriles shqiptare në Kosovë; dihej pak për programin e saj politik e ushtarak, cilat forca politike e mbështesin, çfarë synimesh kishte dhe në cilat rrugë mendonte të shkonte për të bërë të mundur realizimin e një aspirate të vjetër, shtetin e pavarur të Kosovës. Dihej vetëm se ilegalja e vjetër, Lëvizja Popullore e Kosovës, ishte e vetmja që e kishte përkrahur publikisht dhe se e mbështeste financiarisht, por, edhe këto të dhëna, gjithnjë të mangëta, nuk përbënin thelbin e asaj që kishte ndodhur në të vërtetë. Në fakt, jo shumë kohë më parë, zoti Hill, njeriu i plotfuqishëm i diplomacisë amerikane për të zgjidhur çështjen e Kosovës, kishte pasur takime të veçanta me njerëz afër strukturave të UÇK-së dhe të LPK-së, si dhe një takim të veçantë me përfaqësuesin e saj në shtetin shqiptar, Xhavit Haliti. Nga ana tjetër, përfaqësuesi amerikan në Kosovë, Robert Gelbardi, në 22 shkurt 1998, duke miratuar mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare në Kosovë, të planifikuara një muaj më pas, me 22 mars 1998, kishte hedhur mendimin e paplotë, se Ushtria Çlirimtare e Kosovës, sipas tij, "rrezikohej të cilësohej si organizatë terroriste" dhe i kishte kërkuar zotit Rugova një distancim edhe më të ashpër ndaj saj. Ishte, ndoshta, periudha më e jashtëzakonshme në jetën e shqiptarëve të Kosovës, të cilët tani, pas 10 viteve të rezistencës paqësore, ishin thirrur të vendosnin se në cilin pol do të shkonin; drejt polit të lëvizjes paqësore, që drejtohej nga zoti Rugova, apo drejt polit tjetër që po krijohet me shpejtësi, Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Mbi Kosovën ishte një kohë e turbullt, pasi kishin rënduar mbi të dy rreziqe të mëdha; e para, të krijohet vija e ndarjes, që mund të ishte tragjike, mes asaj pjese të popullsisë që mendonte dhe shpresonte ende në një zgjidhje paqësore; dhe, nga ana tjetër, të një lëvizje guerile, e cila do të tërhiqte rreth vetes shumë të rinj, ish të burgosur politikë, militantë dhe figura të njohura për rezistencën e tyre. Vlerësimi diskualifikues i zotit Gelbard se, UÇK-ja mund të cilësohej si organizatë terroriste, do të kapej me vrull nga lideri serb, Millosheviq, që e trajtoi këtë si një mbështetje ndaj aksioneve që kishte ndërmarrë ai deri asaj

dite, por edhe të atyre që kishte ndër mend të bënte. Millosheviq e trajtoi këtë si një hapje dere për politikën e tij, megjithëse deri asaj dite, të gjitha veprimet e SHBA dhe të diplomacisë së saj, edhe pse nuk do të kishin agresivitetin e mëvonshëm, kishin treguar se kësaj here ajo nuk do të lejonte bosnjëzimin e Kosovës.

Nga 22 shkurti 1998 dhe deri në takimin me zotin Holbrook, kishin rrjedhur shumë ujëra. Kishte ndodhur masakra e Prekazit, ku brenda një dy ditshi shfarosës ishin vrarë më shumë se 80 shqiptarë etnikë, mes të cilave edhe lideri i njohur i luftës, Adem Jashari.

Zoti Gelbard, duke ditur se makineria vrasëse serbe sapo ishte vënë në lëvizje, do të jetë diplomati i parë amerikan, që do dërgojë ngushëllimet e tij familjes Jashari. Me 10 mars 1998 ai do të vendosë mbi tavolinën e Millosheviqit fotot e të vrarëve në këtë masakër dhe do të thotë i nervozuar se "këto i gjeni në internet dhe në mbarë botën". Ishte kthesa e parë e madhe e qëndrimit amerikan



ndaj lëvizjes së armatosur, por nuk ishte gjithçka. Gjërat vazhdonin të qëndronin në tehun e thikës. Ishin para luftës tre opsione, tre mundësi: Mundësia e parë, Shtetet e bashkuara, duke dashur të fuqizonin figurën e "kolosit të brishtë të Kosovës," si e quanin ata Ibrahim Rugovën, pra, duke e nxjerrë nga inaktiviteti dhe të bënin më të lëvizshme figurën e tij, të shpallnin se nuk e përkrahin UÇK-në dhe se ajo ishte një organizatë terroriste. Shembuj të ngjashëm kishte pasur në botë, bile në vendet evropiane, si IRA apo ETA dhe, megjithëse UÇK po shfaqej ndryshe, si një lëvizje klandestine e armatosur, më e përmbajtur dhe jo me akte terroriste, rreziku qëndronte gjithnjë mbi kokë. Në asnjë nga vendet e Bashkimit Evropian nuk ishin dhënë sinjale, qoftë edhe të largëta, nëse do të kishte një qëndrim të tillë, kaq të rreptë ndaj një force që kishte vendosur të luftonte. Si dukej, ata prinin, si edhe në raste të tjera, qëndrimin e Shteteve të Bashkuara dhe të diplomacisë së saj, e cila kishte vendosur në Prishtinë një Zyrë të Posaçme dhe ku, veç zotit Gelbard, herë pas here ndodhej edhe njeriu që mendohej të lëvizte gjërat nga vendi, dhe që në fakt i lëvizi, Kris Hill. Shpallja e UÇK-së, si organizatë

terroriste, do të ishte fundi i saj. Pra, megjithëse mund të bëheshin përpjekje për mbi jetesën e saj, në fakt ajo do të ishte një strukturë gjithnjë drejt rrezikut dhe drejt asgjësimit. E gjithë veprimtaria e saj do të cilësohej terroriste dhe portat për të do të ishin të mbyllura, jo vetëm në perëndim, por edhe në shtetin shqiptar, vendi amë i shqiptarëve të Kosovës, i cili, sapo kishte dalë nga kriza e rëndë e vitit të mbrapshtë 1997 dhe, nuk kishte as fuqinë e as dëshirën për një përballje tjetër me perëndimin. Mundësia e parë do të kishte qenë fatale për Kosovën dhe të ardhmen e saj. Mundësia e dytë: UÇK-ja të shpallej si një organizatë ekstremiste, pra të ishte ende nën vëzhgimin e perëndimit, duke i mohuar mbështetjen, pa e nxjerrë ende jashtë ligjit. Një shpallje e tillë, në fillimin e vitit 1998, kur shteti serb po përgatitej për ofensivën më të fuqishme ndaj Kosovës, ofensivë ushtarake, politike e diplomatike për mbylljen përgjithnjë të aspiratës së saj për pavarësi, do të kishte qenë, po ashtu, në mos fatale, shumë e dhimbshme. Mundësia e tretë, UÇK-ja të shpallej, qoftë haptas, qoftë brenda strukturave të botës perëndimore, si një njësi që përfaqësonte njërin nga rrugët për shpejtimin e zgjedhjes së

problemit të Kosovës, për të kaluar më tej, në një përcaktim tjetër, si një forcë që duhej mbështetur. Në kohën e duhur ajo u shpall, u trajtua dhe u mbështet si një force çlirimtare. Të kthehem tani tek takimi i zotit Holbrook me përfaqësuesit e lartë të Drejtorisë Politike të UÇK-së dhe pse kishte një rëndësi themeltare, për të kaluar po ashtu në një moment tjetër, po aq historik: do të ishte një pohim i çastit apo ishte një mbështetje e filluar më herët për të ardhur në këtë ditë. Takimi, i cili zgjati më shumë nga sa ishte menduar, deri në orët e vona të natës, krijoi mundësinë për të shfaqur pikëpamjet e duhura për qëllimin e ngritjes së UÇK-së, për sqarimin e mendimit politik të saj, forcat që e mbështesnin dhe synimet për lidhjet perëndimore; idetë e saj për të ardhmen e Kosovës dhe kalimin e saj përfundimisht në kahun perëndimor të zhvillimeve të mëtejshme. Për përfaqësuesit e UÇK-së ishte i qartë mendimi, i shprehur në takim, se thyerja e gjendjes së status quosë në Kosovë nuk mund të arrihej më me apele të vazhdueshme dhe të përsëritura të Perëndimit drejtuar Beogradit, si kishte qenë nisma e dy ministrave të jashtëm, francez e gjerman, Vedrine - Kinkel, në vjeshtën e vitit 1997.

Kishte ardhur koha që paraqitja e lëvizjes së armatosur të mundësonte që Kosova të hyjë dhe të bëhet pjesë e halleve të qeverive perëndimore, por, edhe më tej, të mund të depërtojë deri në Shtabin e NATO-s, si një rivitalizim i çështjes së Kosovës, dhe, nga ana tjetër, as vetë Perëndimi nuk mund të bëhej faktor aktiv dhe vendosës në çështjen e Kosovës pa UÇK-në. Çështja e Kosovës nuk do të mund të zgjidhej pa inkuadrimin e Perëndimit, çka në radhë të parë, nga njerëzit e UÇK-së, kuptohej se nuk mund të zgjidhej pa inkuadrimin e Shteteve të Bashkuara, sidomos të diplomacisë së saj. Pas porosive të zotit Holbrook, këshillave dhe direktivës së qartë se mund të gjenin mbështetje, vetëm nëse do të qëndronin fuqishëm në linjën e një lufte çlirimtare, aspak terroriste, do të vijë edhe thënia e tij, ndoshta më e rëndësishmja deri asaj dite se: "Më vjen mirë që u takova me njerëz që e dinë se çfarë duan, si duan të ecin dhe ku duan të arrijnë. Ne do ju përkrahim". Kjo është në fakt edhe dita e parë e pavarësisë së Kosovës. Fakt është se, pas këtij takimi, jo shumë ditë më pas, zyrtarë të lartë të ShBA deklaruan publikisht se ata mbajnë kontakte zyrtare me UÇK-në. Është njohja e parë politike e lëvizjes çlirimtare. Vinte nga ShBA dhe ter-

reni për këtë njohje, po aq sa nga lufta në Kosovë, ishte përgatitur nga një plejadë shqiptarësh të shquar, të cilët, përkushtimisht dhe ndershmërisht, kishin krijuar atë mjedis të domosdoshëm, përmes një lobimi të fuqishëm, të vazhdueshëm, që kalonte nga njohjet e zakonshme dhe deri tek takimet e larta presidenciale. Që prej asaj dite do të vazhdonin dhe do të rridhnin shumë ngjarje të tjera, herë pas here epike apo tragjike, do të kishte përplasje të ashpra, vrasje masive dhe do të ndodhte mrekullia, kur Perëndimi, në komandën e ShBA, do të shfaqej haptas pro shtetit të ri të Kosovës, duke vënë në lëvizje forcat ushtarake të NATO-s dhe mendimtarët më të shquar të politikës. Është kjo edhe dita kur vetë Kosova përfundimisht vendoset në krahun e Perëndimit, jo vetëm si mundësi, por edhe si përcaktim historik. Si ndodhi kjo? Përse diplomacia amerikane po kalonte në një ngritje kaq të fuqishme, të cilën nuk e kishte pasur disa muaj më parë? Si kishte ndodhur që, edhe një herë, politika dhe diplomacia amerikane të ishte kaq shumë hapa para mendimit të Unionit Evropian? Takimi i Grupit të Kontaktit në Londër, me 9 mars 1998, që i kushtohej tërësisht Kosovës, megjithëse u mblodh me një procedurë të shpejtuar, çka të jepte shansin e një ndryshimi, nuk i ndryshoi edhe aq shumë konkluzionet e veta, megjithëse toni dukej më i ashpër. Si do të ndodhte edhe më vonë, Grupi i Kontaktit, edhe me 9 mars, kundërshtoi Pavarësinë e Kosovës, pa gjetur zgjidhjen e duhur. Ishte si një lojë fjalësh: Serbia të tërhiqej nga Kosova, por Kosova të mbetej në Serbi. Përcaktimi i zotit Holbrook i jepte fund këtij qëndrimi. Ai po hapte një rrugë tjetër, dhe kjo rrugë dukej se do të ishte e vetmja. Por, përse ndodhi kështu? Përse kjo përmbyse e mendimit diplomatik botëror ndodhi me një përfaqësues të lartë të shtetit amerikan, i njohur për lëvizjet e tij të forta dhe për një dorë të hekurt bisedimesh? Çfarë kishte të veçantë ShBA ndaj partnerëve të saj evropianë dhe pse nisi prej atje të përcaktohej e ardhmja e shtetit të Kosovës, ashtu si, disa dekada më parë, ishte përcaktuar edhe e ardhmja e shtetit shqiptar londinez, në kufijtë e vitit 1913? Është një fakt, i cili, pa asnjë mëdyshje duhet legjitimuar përfundimisht dhe me një ndjenjë të fuqishme krenarie: Në ShBA, ndryshe nga sa ndodhte në vendet e BE, kishte një lob të fuqishëm shqiptaro - amerikan, lob i konsoliduar, me veçantitë e tij, me njerëz të fuqishëm si mendimtarë dhe atdhetarë, dhe me ndikim në të gjithë strukturat e shtetit të madh amerikan.

(Vazhdon)



Demokratët fitojnë zgjedhjet në Louisiana

UASHINGTON, 17 NËNTOR - John Bel Edwards nga radhët e demokratëve ka fituar zgjedhjet lokale në Louisiana të shtunën, pas një gare shumë të ngushtë me republikanin Eddie Rispone. Rezultati konsiderohet si një

disfatë e madhe për presidentin Donald Trump i cili ka mbështetur Rispone, duke vizituar dy herë vendin gjatë fushatës si dhe duke shfrytëzuar këto zgjedhje si test për popullaritetin e tij. Të shtunën, Trumpi kishte bërë disa postime në Twitter duke

kërkuar nga votuesit që ta votojnë kandidatin nga radhët e republikanëve.

Më herët këtë muaj, republikanët nuk kanë arritur t'i fitojnë zgjedhjet as në Kentucky, ndërsa demokratët morën në kontroll të plotë Virginian.



Trumpi thotë se është mirë me shëndet pas kontrolleve mjekësore

Pas lajmit se ai iu nënshtrua një kontrolli mjekësor një ditë më parë, presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, tha se ka kaluar fazën e parë të kontrolleve në Qendrën Ushtarake Mjekësore të Uashingtonit dhe se gjithçka shkoi mirë

UASHINGTON, 17 NËNTOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, tha të dielën se është mirë me shëndet, pas lajmit se ai iu nënshtrua një kontrolli mjekësor një ditë më parë. Trump, përmes rrjetit social "Twitter" tha se ka kaluar fazën e parë të kontrolleve në Qendrën Ushtarake Mjekësore të Uashingtonit. "Gjithçka shkoi mirë. Do të kompletohet vitin tjetër", tha Trumpi duke iu referuar disa analizave dhe kontrolleve rutinë që duhet t'i bëjë çdo vit si president.

Në muajin shkurt, Trump kishte deklaruar se është shumë mirë me shëndet pas kontrolleve rutinë që zgjatën disa orë. Presidenti Donald Trump bëri një vizitë të papritur në një spital ushtarak pasditen e së shtunës për atë që Shtëpia e Bardhë thotë se është një fillim i hershëm i kontrollit të tij të përvitshëm shëndetësor. "Duke parashikuar një 2020 shumë të ngarkuar, presidenti po përfiton nga një fundjavë e lirë këtu në Uashington D. C., për të filluar pjesët e rutinës së tij të ekzaminimit vjetor fizik në qendrën Walter Reed", tha sekretarja e Shtypit e Shtëpisë së Bardhë, Stephanie Grisham, ka njoftuar voa.

Presidenti kaloi rreth dy orë e 15 minuta në kompleksin mjekësor në Bethesda, Merilend. Një fotograf e pa presidentin të dilte nga qendra mjekësore me një jakë të hapur dhe pa kravatë. Sekretarja Grisham, menjëherë

pas largimit të Trumpit, tha se presidenti iu nënshtrua një "ekzaminimi të shpejtë dhe analiza" dhe ai mbetet i shëndetshëm dhe energjik pa ankesa, siç dëshmohet edhe nga prezantimet e tij të fuqishme në mitingjet para mijëra amerikanëve disa herë në javë. Sekretarja e shtypit nuk dha hollësi të tjera se çfarë lloji analizash iu nënshtrua presidenti Trump. Sekretarja Grisham tha se presidenti, sa ishte në qendrën mjekësore, përshëndeti stafin mjekësor "për t'i falënderuar të gjithë për kujdesin e jashtëzakonshëm që ata ofrojnë për luftëtarët tanë të plagosur dhe u uroj atyre një Ditë të mbarë Falënderimesh".

Para se të largohej nga qendra Walter Reed, presidenti Trump u takua gjithashtu me familjen e një ushtari të forcave speciale të plagosur në Afganistan.

Trump, 73 vjeç, u vlerësua në gjendje të mirë nga mjeku i tij zyrtar, komandanti i Marinës, Sean Conley, pas një ekzaminimi në fillim të shkurtit në Qendrën Kombëtare Mjekësore Ushtarake Walter Reed në Bethesda, Merilend.

Presidenti, i cili pëlqen gatimet fastfood dhe mishin e kuq, nuk pi alkoool apo duhan. Ai nuk dihet të ketë pasur ndonjë problem shëndetësor që kur u bë president në janar 2017, por ka një histori të kolesterolit të lartë dhe merr një dozë të ulët ditore të aspirinës për shëndetin kardiak.



ShBA-ja dhe Koreja e Jugut shtyjnë manovrat ushtarake

BANGKOK, 17 NËNTOR - Koreja e Jugut dhe ShBA-ja kanë shtyrë manovrat e përbashkëta të forcave ajrore të planifikuara në fund të nëntorit, në mënyrë që të mbështesin përpjekjet diplomatike me Korenë e Veriut, deklaruan të dielën shefat e mbrojtjes nga të dy vendet aleate, sipas agjencisë koreano-jugore të lajmeve "Yonhap".

Koreja e Veriut ka kritikuar ashpër planet për manovra të përbashkëta ajrore në fund të këtij muaji duke kërcënuar se do të përgjigjej me një "dënim tronditës". "Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Mark Esper dhe homologu i tij i Koresë së Jugut, Jeong Kyeong Doo deklaruan se vendimi për t'i shtyrë manovrat ajrore ishte për të lehtësuar



diplomacinë në mosmarrëveshjen për programin bërthamor me Korenë e Veriut", njoftoi Yonhap.

Të dy aleatët morën pjesë në samitin e ministrave të mbrojtjes të Shoqatës së Kombeve të Azisë Juglindore ASEAN, në Bangkok.

Francezët shënojnë përvjetorin e lëvizjes "Jelekët e verdhë"

PARIS, 17 NËNTOR - Policia franceze ka arrestuar më shumë se 250 veta në të gjithë vendin gjatë protestave që shënuan përvjetorin e parë të lëvizjes së ashtuquajtur "Jelekët e verdhë". Sipas autoriteteve vetëm në Paris u arrestuan 173 veta. Ministri i Brendshëm

Christophe Castaner tha të dielën për radion "Evropa 1" se kishte pak demonstrues të ligjshëm mes atyre që u rebeluan për disa orë të shtunën në juglindje të Parisit. Ai i cilësoi protestuesit banditë të egër, të cilët siç tha erdhën për të luftuar kundër forcave të sigurisë si dhe që të pengonin shërbimet e

urgjencës të kryenin detyrën e tyre. Demonstruesit dogjën disa makina në Paris si dhe hodhën gurë e shishe ndaj policisë që u kundërpërgjig me gaz lotsjellës e ujë.

Lëvizja e ashtuquajtur "Jelekët e verdhë", është shndërruar nga një protestë kundër planeve për

rritje të taksës së karburantit, në një lëvizje që synoi një gamë më të gjerë çështjesh, përfshirë masat ndaj ndryshimeve klimatike deri te mbështetja për familjet e punëtorëve.

Presidenti francez Emmanuel Macron iu përgjigj demonstratave duke nisur në fillim të këtij viti një debat qytetar



mbarëkombëtar. Ai ndërmoi disa veprimeve siç ishte ulja e taksave si dhe rritja e pagës minimale.



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

E jashtëzakonshme

Kompania ofron 3 000 dollarë në muaj për dikë që të testojë hashash çdo ditë

Një kompani amerikane ka bërë një ofertë pune shumë të çuditshme. "Americanmarijuana.org" po kërkon një person që ta paguajë 3 000 dollarë në muaj që të tymosë marijuanë çdo ditë dhe që të ketë një farë njohurie nga cilësia e drogës gjysmë të



ligjshme. Personat e punësuar, përveç 3 000 dollarëve rrogë, do të fitojnë falas edhe pajisje të ndryshme që përdoren për konsumin e hashashit. Dhe si pjesë e punës do të testojnë prodhime të ndryshme kanabisi, që nga vaji e deri te produktet e grënjshme.

FOTO E DITES



Një mjellmë zhytet në Liqenin e Konstancës në Gjermani. /AP/

E rrallë

Fituesi i lotarisë që prishi 11 milionë euro është më i lumtur tani që shkarkon qymyr e s'ka para

Majkëll Keroll fitoi vëmendjen e medieve para disa vitesh kur fitoi një lotari prej më shumë se 10 milionë eurosh. Tani punon si shkarkues qymyri me 10 sterlina për orë. Ai e shkriu të gjithë pasurinë brenda pak vitesh me alkool, drogë dhe prostituta. Sipas tij, ishin 10 vitet më



të bukura dhe nuk pendohet fare që i shpenzoi të gjitha paratë pa kursyer asgjë. Sot ai thotë që nuk i ka humbur paratë, por i ka shpenzuar. Ai fajëson edhe shoqërinë "grabitqare" për mbarimin e parave. Po t'i bjerë prapë lotaria, thotë se nuk do ta lërë punën as edhe një ditë.

BARSOLETA E DITËS



Goni: Pse po qanë motra jote e vogël?
Toni: E ndihmova.
Goni: Çfarë e ndihmove?
Loni: Ta hajë çokollatën.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora 14:00

ABOMINABLE 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 32 min

Rolet: Chloe Bennet, Tenzing Norgay Trainor, Albert Tsai, Eddie Izzard, Sarah Paulson, Tsai Chin, Michelle Wong, etj.
 Regjia: Jill Culton



Çdo ditë në ora 16:00

TOY STORY 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.
 Regjia: Josh Cooley



Çdo ditë në ora 18:00 dhe 20:00

MALEFICENT MISTRESS OF EVIL 3D

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 orë 58 min

Rolet: Angelina Jolie, Elle Fanning, Chiwetel Ejiofor, Sam Riley, Ed Skrein, Imelda Staunton, Juno Temple, Michelle Pfeiffer, etj.
 Regjia: Joachim Ronning



Çdo ditë në ora 22:00

ZOMBIELAND DOUBLE TAP

Aksion/Komedi/Horror; 1 orë 39 min

Rolet: Woody Harrelson, Jesse Eisenberg, Emma Stone, Abigail Breslin, Rosario Dawson, Zoey Deutch, Luke Wilson, etj.

Regjia: Ruben Fleischer



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Kur dikush të shfaqë sjellje të papërshtatshme sot, nuk duhet të tolerohet nga ju apo dikush tjetër. Bëhu ti i pari që e kundërshton një fyerje të nxitur.</p>	 <p>DEMI Nëse doni që sot të qëndroni vetëm për pak kohë, përpuni të mos zgjasë shumë që njerëzit të mos shqetësohen se ku keni shkuar.</p>	 <p>BINJAKËT Koha është gjithçka kur bëhet fjalë për disa lloj marrëdhëniesh - kështu që përpuni të mos i nxitoni gjërat.</p>	 <p>GAFORRJA Ju keni qenë disi dyshues për dikë për një kohë, por nuk keni mundur të kuptoni arsyen pse. Flisni me të dhe kjo do ju ndihmojë të kuptoni arsyen e ndjesive që ky person ju ka krijuar.</p>	 <p>LUANI Nëse ai nuk është i aftë për të pranuar situatën tuaj, atëherë duhet të jeni ju të aftë për të pranuar të tyren edhe pse nuk jeni dakort me të.</p>	 <p>VIRGJERESHA Besnikëria është një nga gjërat më thelbësore për çdo miqësi, kështu që ju duhet të qëndroni pranë miqve tuaj kur ndodhin keqkuptime apo probleme të ndryshme.</p>
 <p>PESHORJA Sot, dikush që ka shumë rëndësi për ju shumë do ju kërkojë ndihmë. Ajo që këta persona duan mund të mos ju pëlqejë fort.</p>	 <p>AKREPI Energjia juaj është shumë e ulët dhe do të jetë e lehtë për ju që të shpërqendroheni sot, kështu që mos u frikësoni nëse gjatë një bisede apo takimi mendja juaj fillon të bredhë.</p>	 <p>SHIGJETARI Ju duhet të ushtroni kreativitetin tuaj aq sa mundeni sot - vallëzoni, këndon, rimoni dhe përdorni të gjitha aftësitë tuaja unike të vetë-shprehjes për tu argëtuar!</p>	 <p>BRICJAPI Të ndiheni të fortë është përgjegjësia juaj. Në fakt njerëzit që ju rrethojnë janë zakonisht arsyeja që bëni gjëra që nuk janë të mira për shëndetin tuaj!</p>	 <p>UJORI Ata nuk dinë të pyesin por në të vërtetë kanë nevojë për kontributin tuaj dhe idetë e mira që mund t'i jepni.</p>	 <p>PESHQIT Ai mund të jetë i befasuar nga guximi juaj, por do ta vlerësojë faktin që ju doni të qartësoheni. Do të shihni sesi të qenit i sinqertë është gjithmonë një gjë e mirë për marrëdhëniet.</p>

Zbulohen detaje nga dasma e Jennifer Lopezit



Alex Rodriguez i propozoi martesë Jennifer Lopezit në muajin mars dhe pritet që së shpejti ata ta kurorëzojnë dashurinë. I ftuar së fundmi në emisionin "The Tonight Show" me Jimmy Fallon, Alex zbuloi detaje për planet e martesës. Ai tregoi se ende nuk kanë zgjedhur vendin ku do ta organizojnë dasmën,

por tha se ata po mendojnë diçka intime. Alex shtoi se në dasmën e tyre do të ketë më pak se 100 të ftuar dhe ata pëlqejnë të mos e bëjnë publike. Dasma nuk është zbuluar ende se kur do të mbahet, megjithatë festimet kanë nisur. Në muajin shtator çifti mbledhi miqtë dhe të afërmit në një festë intime.

Blake Lively heq të gjitha postimet nga "Instagram"-i



Aktorja Blake Lively ka bërë një ndryshim të madh në logarinë e vet në "Instagram". 25.8 milionë ndjekësit e saj u befasuan pasi aktorja 32-vjeçare vendosi t'i fshijë të gjitha

postimet në këtë rrjet social, përveç një. Postimi që Blake vendosi ta linte aty ishte trileri për filmin e saj të ardhshëm "The Rhythm Section". Ky film do të dalë në kinema më 31 janar 2020.



Meghan dhe Harry krishtlindjet do t'i festojnë me nënën e Dukeshës dhe jo Mbretëreshën

Duka dhe Dukeshja e Sussex dhe djali i tyre, Archie Harrison Mountbatten-Windsor, do t'i kalojnë krishtlindjet e tyre të para si një familje me nënën e dukeshës, Doria Ragland. Anëtarët e familjes mbretërore tradicionalisht kanë kaluar periudhën festive me Mbretëreshën në

Sandringham, ku ata marrin pjesë në festën e mëngjesit në kishën St Mary Magdalene. Pasi morën pjesë në shërbimin në Sandringham së bashku për dy vjetët e kaluara, këtë vit Meghan dhe Princi Harry nuk do të bashkohen me familjen mbretërore për rastin festiv.

Lena Waithe martohet fshehurazi



Lena Waithe është një grua e martuar. 35-vjeçarja zbuloi së fundmi se ajo dhe Alana Mayo ishin martuar fshehurazi. "Ne nuk kemi bërë asnjë njoftim.

Shkuam në San Francisco dhe u martuam. E gjitha ishte ide e saj", ka thënë ajo. Lena dhe Alana janë bashkë për disa vite dhe janë fejuar në vitin 2017.

A jetojmë në kohën e 'Vrapuesit në teh'?



Fantashkenca e vitit 1982 e imagjinoi një metropol distopian, ku ngjarjet zhvillohen në nëntor 2019. Davit Barnett analizon për BBC-në se deri në ç'masë ai film e ka parashikuar realitetin e sotëm. Pjesë të shkrimit të tij, Telegrafi sjell më poshtë

Qyteti shtrihet aq sa syri mund të shohë; dritat shkëlqejnë në ndërtesat e ngjitura me njëra-tjetrën – për dallim nga yjet që janë të padukshme në qiellin e natës të mbushur me smog... Flakët dalin nga kullat gjigande industriale. Një automjet fluturon në skenë, duke shkuar drejt dy piramidave monstruoze.

Një burrë gjithnjë e më i shqetësuar i nënshtrohet një testi verbal të zbatuar nga mbikëqyrësi i Korporatës "Tyrell". Shohim një makinë tjetër fluturose, që kalon në rrugët e ngushta të qytetit, me banerë digjitalë që paraqesin një grua aziatike që reklamon ushqim. Një zë me ngazëllim u flet banorëve për jetën në kolonitë e jashtme...

Natyrisht, kjo më nuk është e ardhmja. Është "Blade Runner" ("Vrapuesi në teh"), film i vitit 1982 me regji nga Ridley Scott i bazuar në romanin e vitit 1968 të shkrimtarit Philip K Dick, "A i ëndërojnë robotët delet elektrike?" që flet për personin Rick Deckard, një polic i cili ndjek replikuesit "në pension" – humanoidët artificialë të inxhinierizuar gjenetikisht, pothuajse njerëzorë, prania e të cilëve në Tokë është e paligjshme pas një revolte në një nga kolonitë jashtë botës.

Kjo mund të tingëllojë larg nga realiteti ynë sot, por siç thuhet në fillim, ngjarja është vendosur në Los Anxhelos, në nëntor 2019. Pra, ky nuk është më film i fantashkencës. Është triler. Çështja është kjo: në 37 vitet nga shfaqja,

sa afër është paraqitur e ardhmja? Nga njëra anë, janë ca detaje të vizionit për vitin 2019, që duken të çuditshme. Nuk ka internet dhe kur takohemi së pari me Deckardin, ai e lexon një gazetë të vërtetë, ndërsa zë strehë nga shiu pranë dritares së një dyqani që shet televizorë të vjetër katodikë... Ndërkohë, kur e kryen testin Voight-Kampff – një provim për të dalluar replikantët nga njerëzit përmes përgjigjeve emocionale – ndihmësja e Eldon Tyrellit, shefit të kompanisë që krijon replikantët, pi cigare! Rachel pi cigare! Në zyre? Bota e "Blade Runner"-it është ajo në të cilën konglomerati "Tyrell" dominon bashkë me të tjerat që shfaqen te disa prej reklamave masive të neonit – duke luajtur me fatin nëse bizneset aktive të vitin 1982 do të vazhdojnë në vitin 2019. Coca-Cola ishte bast i sigurt, por PanAm-i bankroti më 1991. Nga ana tjetër, jemi prapa në shumë aspekte teknologjike, ndonëse ca gjëra nuk janë të pamundshme. P.sh. kompania gjermane Liliun, njoftoi muajin e kaluar se makina fluturose që po e zhvillon mund të jetë në përdorim si shërbim taksie më 2025. Nuk kemi njerëz artificialë, por kemi bërë përparime të mëdha në redaktimin e gjeneve. Ende nuk kemi nevojë për testin Voight-Kampff, por sa herë ju kërkohet të shënoni semaforët në një foto për të dëshmuar se s'jeni robot kur doni të keni qasje në një faqe interneti?

Sidoqoftë, "Blade Runner"-i kapet

më shumë me ca tema socio-politike, aktuale në vitin 2019, thotë Michi Trota, redaktore në revistën "Uncanny Magazine".

"Filmi e parashikon distopianë të dominuar nga interesant dhe korporatat, nga efekti në ambient i industrializimit masiv, shteti policor dhe tekta e të pasurve e të fuqishmëve që rezultojnë në kaos dhe dhunë, ndërsa e pësojnë margjinat sociale", thotë ajo.

Në film, replikantët kanë jetëgjatësi prej 40 vjetësh. Trota beson se ka "diçka të ndërjegjshme në zhgënjimin dhe mllëfin e replikantëve për jetën e shkurtë, që vjen si rezultat i lakmisë së korporatës dhe indiferencës ndaj gjendjen aktuale të kujdesit shëndetësor në ShBA dhe shfrytëzimit të punëtorëve".

Sa i përket efekteve shkatërrimtare nga ndotja dhe ndryshimi klimatik që është i dukshëm te "Blade Runner"-i dhe vazhdimi i vitit 2017, "Blade Runner 2049", "kolapsi mjedisor që aq mirë shfaqet nuk është larg asaj që jemi sot", thotë shkrimtari i fantashkencës dhe programeri Matthew Kressel, duke treguar foton famëkeqe të smogut në Pekin më 2013, që duket si sekuençë nga filmi. "Ndërsa, po i nënshtrohemi zhdukjes më të madhe masive, që nga dinosaurët 65 milionë vjet më parë. Po ashtu, përshkrimi i filmit për bollëkun dhe mungesën, ata që mund të bëjnë jetë të mirë derisa të tjerët jetojnë keq, është paralele e pabarazisë së madhe të shpërndarjes së pasurisë sot mes të pasurve dhe të varfërve. Në këtë aspekt filmi është mjaft i saktë".

Në komentin e Kresselit më lart, Pekini – nga ku është kthyer autorja e fantashkencës, Mary Robinette Kowal – ka qenë pikë referimi kur diskutohet për metropolin e "Blade Runner"-it. A është qyteti i madh kinez përfaqë-

sues më estetik i filmit sesa Los Anxhelosi i ditëve të sotme? "Smogu nuk ishte shaka, kështu që në këtë aspekt, po", thotë Kowal. "Por, në pjesët e Pekinit ku isha, pashë mbivendosje të konsiderueshme të së vjetër dhe të resë. Secila dukej e manifestuar në mënyrë të barabartë. Përveç cilësisë së ajrit, ishte qytet i pastër, modern, i ndërthurur me zona historike".

Çështja është nëse "Blade Runner"-i i vitit 1982 e parashikoi saktë botën e vitit 2019? Dhe, a është detyra e fantashkencës të jetë parashikuese, apo thjesht zbatimëse? Apo ndoshta diçka më shumë?

Kowal thotë se është më pak e interesuar për cilësitë e parashikuese të zhanrit, sesa për mundësitë që ofron si "një shesh lojërash për eksperimente mendimi". "Kjo na lejon ta kapim botën tonë, të shohim indet e ndërlydhura e pastaj të tërheqim zinxhirët logjikë të kauzalitetit për të ardhmen. Fantashkenca ka rëndësi, jo për shkak të teknologjisë aty, por për shkak të dilemave që na detyron të shtrojmë. Për shembull, 'Blade Runner' pyet për moralin e krijimit të një jete të ndryshme me qëllim të skllavërimit".

Trota pajtohet se fuqia e vërtetë e fantashkencës shtrihet në çështjet më të gjera filozofike që eksploron. "Shpesh mund të bëhet fjalë për të ardhmen, mund të jetë 'parashikuese', por ato parashikime janë gjithashtu reflektuese për çështjet tona të përditshme dhe për të kaluarën tonë".

Romani i fundit i Kowalit, e paraqet ShBA-në me histori alternative, ku një pilot dhe një matematikane udhëheqin misionin e njerëzimit drejt kolonizimit të botëve tjera, pasi ndryshimi apokaliptik i klimës e shkatërron Tokën. Autorja thotë

se "Blade Runner" i ka modeluar "shumë ide tona se si duket e ardhmja... Ndotja, biseda me kompjuterët, korporatat që drejojnë vendin dhe dilemat etike se kush konsiderohet person...". Nëse nuk është tamam parashikuese, fantashkenca ka lidhje me të tashmen. Kowal thotë: "Shumë njerëz nga fusha e STEM-it (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë – vj.) i citojnë filmat ose librat e fantashkencës si frymëzimi për ndonjë zbulim. A e shpiku 'Star Trek'-u telefonin që palohet, apo e nxit? A e parashikoi '1984'-shi shtetin e Vëllait të Madh apo e ndaloi të përhapet?"

Po ashtu, fantashkenca mund të jetë paralajmërim për të përmirësuar drejtësinë që marrim. Askush nuk dëshiron të jetojë në Nëntorin 2019 të përshkruar nga "Blade Runner", apo jo? Kressel nuk është shumë i sigurt.

"Në një farë mënyre, 'Blade Runner' mund të cilësohet si rrëfimi i fundit paralajmëruar", thotë ai. "A ka ekzistuar ndonjëherë një vizion kaq i zymtë që tregon sesi degradimi i mjedisit, dehumanizimi dhe tjetërsimi personal janë kaq të dëmshëm për të ardhmen e botës? Megjithatë, mos asgjë tjetër, 'Blade Runner' tregon dështimin ndaj paralajmërimit. Në vend të kësaj, e kemi fetishizuar vizionin distopik të filmit. Shih pjesën më të madhe të artit që përshkruan të ardhmen, përmes letërsisë, filmit, artit pamor, dhe në pothuajse të gjithat do të shohim jehonën e distopisë së zymtë të 'Blade Runner'-it. 'Blade Runner' e bëri distopinë më 'atraktive' dhe sot jemi këtu duke u marrë me kolapsin mjedisor teksa digjen hektarët e pyjeve tropikalë. Mos asgjë, duhet të mendojmë pse nuk arritëm të dëgjojmë paralajmërimet që na u dhanë".

/Telegrafi/

“Një komp pa liri politike është më keq se një njeri lidhur në hekur”

Nga: Mit'hat FRASHËRI

Në kohë që është i vogël njeriu ëndëron dhe thotë: – Kur do të vijë dita të bëhem i math, të dal nga djalëria. Të rritem, të urdhëronj vetëhen, të dal nga kujdesi dhe nga vëshgimi i të tjerëve. Sa vjet, sa shekuj, sa brezni kemi pshertitur prapa liris s' ënë si komp, prapa independencës së kësaj Shqipërie! Çdo gjë e gjallë në botë ka detyrën të rrojë, të mprojë vetëhen. Dhe që të rrojë duhet të mprohet prej rreziku, të marrë masa për pritmin, të mejtojë jo vetëm për sot, po edhe për të nesërmen, të përgatitnjë udhën e lumtërisë.


Një njeri që s'ka liri, një skllaf, nuk është i zoti i vetëhes' së tij të punojë dhe të realizojë jetë fatbardhe. Një komp pa liri politike është më keq se një njeri lidhur në hekur.

Lirin e një personi të vetëm e tolerojnë shumë despotë, po lirin e një kolektiviteti si komp s'e duron asnjë dominatër i huaj. Si individ munt të na japin lehtë, mbase edhe na ndihmojnë. Por si shoqëri, si trup je i ndaluar nga çdo veprim. Dhe në është independenca një qok dhe një qëllim që e ndjekim pa reshtur, kjo është pse independenca na le të lirë të përpiqemi për të mirën t'ënë kolektive, na e fal atë të drejtë, na 'zgjith duar e këmbë të punojmë për një jetë më të mirë, më të bukur dhe më të ndershme.

Në qoftë, pra se skllavëria dhe despotizmi janë një turp për njeri, liria dhe independenca formojë një titull fisnikërie për të. Në një gjuhë të huaj ka një fjalë të shkurtër dhe fort të bukur – “Noblesse oblige” thotë. Fisnikëria i ngarkon njeriut një tok detyra, një tok barrë që rjedhin nga të drejtat e tij. “Noblesse oblige”, është një mendim lindur në inteligjencën e një populli nek i cili ushqehesh shpirti i nderit, i kalorisë, i oborsisë, një popull që kishit për detyrë të vdesë atje ku e lyp nderi, të vërë këtë nder dhe sedrë më parë se çdo send tjetër.

Do të donja pra që sa herë moti na përtërit 28 Nëntorin, në mes të gëzimit dhe manifestimeve, të kujtojmë detyrën, dhe me detyrën, përgjegjësinë t'ënë.

Kemi para së gjithash detyrën të rrojmë. Dhe që të rrojmë duhet të krijojmë një mentalitet të shëndetshëm, me një kuptim të kthiellitë. Anijeja që udhëton në brym' e në mjegull thyhet në shkëmbënjtë; njeriu që ecën në t'errët bje në gropë. Kaqë më tepër akoma duhet të çel një sytë një shoqëri dhe të dijë ku vete, të dojë të kuptojë ku duhet të vejë. Fisnikëria na ngarkon barrë të rëndë, dhe kur ritemi dhe



bëhemi burrë duhet të punojmë si burrë e si fisnik. Të bindemi një her' e mirë se iku ora e marrëzivet, e pakujdesivet, e lodravet.

Gjëndemi përpara një problemi të math dhe duhet të qendrësojmë, mendimin t'ënë.

Një problem i math, do mjete të mëdhenj, do fuqi të fortë. Do pra bashkëpunim midis njerësve të kombit, me qënë se është për interesin e përbashkët. Duhet të marrim pjesë aktive, një interesim të gjallë, si të zotërit e punës që jemi, si proprietarë të këti vëndi, dhe jo si të huaj, si qiraxhinj.

Do të rrimë kurdoherë në Shqipëri, dhe atje do të vdesim, edhe ne edhe djemt' t'anë, sikundër që atje lintnë prindërit dhe stërgjyshërit t' anë. Kjo shtëpi është e përbashkët; ky kopsht është i të gjithëve. E mira dhe e keqja është për të gjithë. Lëngata e më të largut fare nesër na kap edhe neve. Faji i tjetrit më zë edhe mua. Kur të çelet dheu bjemë të gjithë brënda dhe furtuna kur e mbyt vaporin të gjith' udhëtarët bjen' në valë.

Duhet të kemi bindjen se, për të mirën e përbashkët kemi nevojë dhe detyrë të punojmë të gjithë së bashku. Edhe kështu çdo e mirë, ose çdo e keqë vjen prej nesh, mvaret nesh.

Kështu është sot, kështu do të jetë nesër, kështu edhe gjithmon e jetës. Në shtëpit t'onë të madhe që i themi Shqipëri, mos kemi shpresë veç se nga punimi dhe nga veprimi ynë. Atë që mbjellim atë do të korrim.

Arrin që të duamë, të punojmë dhe të veprojmë me këmbëngulje, forcë vullneti, me tenacitet, me perseverencë, pa u-mërzitur, pa uzvertitur. Na duhet një punim i gjatë, i vazhduarshmë, inteligjent dhe i logjikshëm, dhe gjithë me një zemrë, se lumtëria ime personale ka për kusht lumtërin e

përbashkët.

Atë farë që hedhim, atë pemë do të marrim. Por, a jemi bindur se pa punuarë a' kemi të drejtë jete? A na është mbushur mëndja një her' e mirë se pa mbryjtur e pa gatuar s' kemi bukë as sot, as nesër? A e kemi mirë kuptuar se, çdo-cili meriton të rrojë si pas punës që bën – me krahë e me lodhje – dhe jo si mbase fjalëvet të kota që flet?

Varfëria morale dhe fizike, robëria personale dhe, shoqënore vijnë nga të folurit shumë, dhe të punuarët pakë.

Fuqinë duhet të ja japim, jo gojës me gjuhën, po krahvet, krahorrit, zemrës dhe mushkërivet. Sicilado nga këto fjalë është një program më vetëhe dhe për shvillimin e tyre do të ishte nevojë jo një, po disa artikuj.

Do të ishte kjo nevojë gjer sa të na hyjnë këto të vërteta thellë në çelulat e trusë, në fibrat e zemrës, të formojnë themelin e moralit t'ënë individual dhe kolektiv. Kur qenkemi të gjithë të interesuar në jetën dhe lumtërin e përbashkët, atëhere e kemi për detyrë të ndjejmë se i cili prej nesh përgjegjësinë që i takon, se kjo përgjegjësi është e përbashkët: imja, jotja, e ati, e atyreve.

Do të jeshë padyshim fort i kënaqur, këndonës, sikur të të thoshnja se faji s' është yti, se ti s' ke asnjë përgjegjësi. Do t' a ndjenje vetëhen t' ende të lumtur duke hedhur gjithë gabimet, gjithë sharjet mbi tjetrit, mbi të tjerët, dhe ti të dilnje inocent, mbase dhe martir. Për fat të keq njeriu s' është engjëll!

Mirësia lyp një edukat' të gjatë dhe një stërvitje të përditëshme. Prandaj na pëlqen të kallzojmë të afërmin, të ngarkojm' atë me çdo krim, me çdo padrejtësi. Mos e prit, këndonjës i dashur, këtë demagogji prej meje.

Të kam për të thënë të vërtetën e athët, sikundër që s't'a kam

kursyerë që kaqë vjet. Do të më vinte turp të të gënjenj ty, dhe më tepr' akoma do të skuqesha: në rrejsha vetë vetëhen. Dhe e vërteta është se, cilido nesh duhet të shohë si përgjegjës personën e tij. Para se të themi çë bëri, si veprim aksecili, duhet të pyesim sinqerisht dhe me ndërgjegje çë bëra unë, si veprova unë. I vetëmi moralitet konstruktif është të mbajmë përgjegjëse vetëhen t'ënë: atëhere, dhe në këtë mënyrë, munt që të shohim fajin, të përpiqemi të korektohem, të çvishemi prej të metave dhe të fitojmë cilësi të dobishme.

Është një “ushtrim spiritual” laik, jo vetëm moral, po edhe patriotik. Kurse, e kundërta e kësaj mënyre, në qoftë se nxjerrim vetëhen t'ënë pa faj, dhe akuzojmë kurdoherë tjetrit, atëhere s' bëjmë as një forcim të përmirësohemi, nuk ndreqim të metat, shtojm' armiqësitë dhe bisedimet e kota, dhe rezultati del në dëm të përgjithshëm.

Kjo e vërtetë kaqë simple është edhe për mua, edhe për ty, këndonjës, edhe për të gjithë neve. Një e vërtetë fort simple dhe fare sheshazi, ka nevojë shpesh herë të repetohet, të përsëritet çdo mëngjes e çdo mbrëmë. Dhe është një detyrë elementare që të bindemi thellësisht ne vetë, pastaj të bindim të afërmit t'anë se, rrojta dhe pritmi varen nesh kolektivisht; në bashkëpunim dhe solidaritet me shoku shokun. Noblesse oblige. Independenca na bën me jetë, me shtëpi, me fëmijë, me komp. Na jep barrën t'a meritojmë, t'a mprojmë, t'a ruajmë, të plot e të pa cënuar, të nderuar dhe të pëlqyer, për lumtërin t'ënë.

Duhet të respektojmë këtë independencë; të kujdesemi të na respektojë bota. Dhe një komp është si një individ: Që t'a respektojë tjetri arrin që të respektojë me të vërtetë vetëhen e tij.

E di se kemi ardhur në një kohë të

keqe, një epokë vështirësisje, krizë morale, ekonomike dhe politike për botën e tërë. Nga këto fatkeqësi, nga shkatërimi i traditave, i disiplinës dhe i hierarkisë, vuan e tërë bota, gjithë Shtetet e dheut, edhe ata që kanë qënë të fort e t'organizuar.

Është natyrisht logjik që edhe ne do të ndjejmë të këqijat e sotme të kohës. Edhe bash pse jemi në një minutë kritike të situatës së përgjithëshme, prandaj duhet të çelim edhe më tepër sytë, të jemi më të kujdesur. Kom be të gjerë dhe të mëdhenj, munt t' a shikojnë me besim kohën; koha për ta munt të jetë gentleman, galantuomo.

Po një popull i vogël ka detyrë t'i japë kohës një ndihmë të fortë, të ecën përpara kohës, dhe të mprojë vetëhen e tij. Çinteresimi në fushë të veprimit patriotik është një faj dhe një krim. “Ç'më lipset mua”, si edhe “Ç'të duhet ty”, janë fjalë shkatronjëse. Përgjegjësi dhe të drejtat janë të përbashkëta, sikundër që interesimi i të gjithëve është një detyrë dhe një nevojë.



Në qoftë se shumë faje dhe shumë gabime bëhen në botë, kjo vjen pse një pjesë e madhe e popullit s'njeh, s'di, s' kupton interesin e vërtetë të tij, rri indiferent ne jeta e përbashkët, ose, më keq akoma, e shikon vetëhen e tij të huaj dhe armik, i shikon të tjerët armiq dhe të huaj.

Ay që shikon, sheh dhe gjykon ka një barrë të rëndë në këtë lëmë. Inteligjenti që kupton detyrën duhet të ngrerë barrën. Dhe barra e çdo Shqiptari me ndërgjegje është të interesojë palët e thella të njerëzisë, stratat e popullit dhe vlezrit e kombit, duke u rrëfyer edhe atyreve cila duhet të jet udha e tyre, ç' detyrë dhe përgjegjësi kanë.

Padyshim ky program tërheq mundime të panumërtë. Po jemi të shtrënguar të lodhem e të punojmë, në mos vetëm për ideal dhe, moralitet, të pakën për interesin e vërtetë t'ënë.

Në një kohë në të cilën egoizmi dhe indiferenca shikohen si parime me të cilët ndodhen njerës që lëvdohen dhe mburen, në një periudë që verbëria dhe qenizmi shikohen si virtute, të bërë e një detyre kundrejt kombit dhe vëndit, a nuk duhet të mbushnjë aktivitetin e atyreve që vështrojnë dhe gjykojnë? Dhe këto detyra duan bërë me entuziasmë dhe duke inspiruar entuziasmën: Si për njerinë, ashtu dhe njerëzinë entuziasma dhe lithka në një ide e mbajnë gjallë; besimi në një qëllim i japin fuqi, dhe e ngushëllojnë. Një komp shuhet dhe vdes kur humbet entuziasmën.

Botuar fillimisht në Revistën “Përpjekja shqiptare”, në numrin e dhjetorit 1936/

Autor: GAZMEND MORINA	KËNGËTARJA PIREVA	QYTET I LASHTË NË ILIRI (shq.)	PAKTI USHTARAK MË I MADH NË BOTË	OREGON DEPARTMENT EDUCATION	VAJTIM ME LOT	PJESË E HAPUR NË MURIN E NJË NDËRTESE, E MBYLLUR ME XHAME	EPOKA ERE	BASHKËTING- ËLLORE	LLOJ DRURI	DJALË OSE VAJZË DERI TETË A NËNTË VJEC (bised.)	EMËR I VJETËR PËR VIETNAMIN	DESPOTI	 1							
AKTORI NË FOTO 1 SCHWARZEN- EGGER	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	I GJYMTUAR AI QË E KISHTE DOBËSI THEMBRËN													
MARKË E VESHJEVE SPORTIVE								BUJTINA ZANORE												
SHKENCA QË STUDION TË BUKURËN									DAFINË UDHËHEQËS I NJË ORGANIZATE											
LAONSA (shk.)				INTENSITET, TITAN KËNGËTARE ME FAMË BOTËRORE (shqip.)				KAFSHË PËR NGARKESË NË AMERIKËN LATINE PULLË E TASTIERËS												
INDIUM			EMALIM QYTET NË KOSOVË								NEVADA GRUP I VOGËL BESIMTARËSH ME NJË DOGMË TË VEÇANTË									
AKTORJA HOLLIVUDIANE KOKS						BANORI I KRYEQYTETIT TË ARABISË SAUDITE FUTBOLLISTI RYAN (Liverpool)														
ZANORE		BANORE E LABËRISË RRJET I NGATËRRUAR KALIMESH E SHTIGJESH					SELEN KAMPIONI (Sport)			ZANORE FUTBOLLISTI ARGJENTINAS PABLO (Benfica)		FILMI I PARË SHQIP	U ARRATISA	ATDHE (krah.)	EPOKA ERE	MESI I TRUPIT TË NJERIUT	QË NISËT VETËM NGA DOBIA E MOMENTIT			
EPOKA ERE	LLOJ VEGLE MUZIKORE ENË QË LQI E RRUMBULLAK- ËT ME GRYKË TË GJERË E ME KAPAK					ZBAVITËS, TËRHEQËS FUTBOLLISTI KROAT KLASNIÇ									BOLIVIA, URUGUAI EMËR YNI FEMRE					
LLOJ BIME NARKOTIKE								"TENESI"	BASHKËVEN- DËSET E ODISEUT KUZHINË PRANË XHAMISË											
"B" në mes të dy "A"				SHMANGIE E DIKUJT METALI FORTË ME NGJYRË HIRI							AKTORJA AMERIKANE PORTMAN (shqip.) TINARI									
"VIENA"		UÇK (ang. orig.) GRIMCË MOLEKULARE					E PESHOVA (bised.) PËREMËR VETOR					TRAJNERI YNË VOKRRI RROGA VJETORE E PAPËS								
BUJK					NATRIUM SHEGË			FLORIRI ENVER PETROVCI				NËNË (turq.) KËNGËTARJA ... QAZIMI					ZANORE BANOR I NJË SHTETI EVROPIAN			
ELEMENT						DEM. KA TËRËSIA E TEMAVE				KLUB FUTBOLLI FRANCEZ (shqip.)					HISTORIANI ROMAK LIVI RADIOLO- KATOR					
FJALË TINGULLIMIT- UESE										BISKOTË E GATUAR ME ARRA (shq.) FSHATI KU NDODHET AEROPORTI I TIRANËS										
ZWEIFEL TEXTILE MACHINERY				VRANËSIRË			FIGURË STILISTIKE	DY BASHKË- TINGËLLORE "R" pas dy "T"			FILMI YNI "... ISHIN KATËR" VËNIA E MINAVE					ANA RUSO OLIVIA GARNER				
2																				
KRAHINË NË SHQIPËRI									INVA MULA NJËSI E VJETËR PESHE			IDHULL ZANORE						BASHKËTI- NGËLLORE		
AKTORI AMERIKAN NË FOTO 2 SABATO	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	REGJISORI SOPI METAL ME SHKËLQIM SI TË ARGJENDIT							
KËNGËTAR I FAMSHËM TURK												DY BASHKË- TINGËLLORE KËNGËTARJA SHQIPTARE VALBONA		ZANORE "EPOKA E RE"			I FILLOJ			
ISLANDA, FINLANDA						LUFTËTARI VOKSHI (shq.) ROK BEND I YNI						KËNGËTARJA JONË E RE ... KOÇI GODINA MBI LUMENJ								
PA DOBI, PA NDOJË PËRFITIM								I KËPUTUR; I MPAKUR DY ZANORE									BASHKËTING- ËLLORE PRODUKT I ZJARRIT			
COPEË LECKE PËR ARNIM (shq.)										EMËR YNI MASHKULLI TOTENHAM						HAITI, INDIANA SHKRONJA XIX				
EPOKA ERE	BABAIT										KËNGËTARJA KANADEZE MORISSETTE									

ANKTHI I MËNGJESIT - NGA SE SHKAKTOHET DHE SI TA PËRBALLONI

Ankthi është një gërshetim i ndërlikuar emocione negative që përfshijë frikën e tepruar, shqetësimin apo panik të lehtë. Zakonisht shoqërohet dhe me pasoja fizike si rrahje të forta të zemrës, dhimbje të kraharorit dhe një frymëmarrje të çrregullt. Krizat e ankthit të mëngjesit, është ai që të kap sapo hapim sytë, duke shkaktuar pasiguri, plogështi dhe lodhje të rënduar. Në fazat më të rënda, ky shqetësim shoqërohet dhe me marrje mendsh, të vjella dhe me një sistem tretës jo të qetë. Në shumë raste, kur zgjohesh në një mëngjes të tillë mendja të shkon menjëherë tek konsumimi i një kafeje, tek disa persona ajo ka efekt qetësues por tek disa të tjerë kafja ndikon në rritjen e mëtejshme të ankthit.

Dy format e ankthit të mëngjesit

Ankthi i mëngjesit që shfaqet menjëherë pas zgjimit të orga-



Njerëzit që pijnë sasi mesatare të kafesë janë 3 herë më të rrezikuar nga këto probleme. Foto: Flickr

nizmit, ndërkohë që jemi ende shtrirë.

Simptomat e këtij tipi të ankthit lidhen me një tension në të gjithë trupin si dhe me rrahje të çrregullta e të forta të zemrës. Duke ndikuar në gjendjen psikologjike dhe fizike të person-

it të prekur gjatë ditës.

Forma tjetër e ankthit të mëngjesit është ai që del në pah pas disa minutash që jemi zgjuar.

Një gjendje e cila rritet gradë pas grade derisa arrin të formohet një dhimbje në kraharor. Në të dy rastet e ankthit të mëng-

jesit, vëmendja dhe përqëndrimi është i ulët.

Disa nga reagimet fizike ndaj ankthit të mëngjesit janë: ngërçet të muskujve, kriza të stomakut, dhimbje të qafës dhe të kokës.

Një nga karakteristikat kryesore të këtij lloji ankthi është plogështia që kap organizmin në mesditë.

Simptomat e ankthit të mëngjesit

Lodhje e vazhdueshme nga detyrimet e përditshme, pa pasur mundësi për të rikuperuar energjitë.

Një numër i lartë përgjegjshmëri

ish

Një çrregullim i mënyrës së jetës, apo pamundësia e organizmit të saj

Mos interesim në aktivitetet e zakonshme

Pritshmëri të larta dhe të pakapshme

Nervozizëm dhe irritim

Si të përballoni ankthit e mëngjesit

Për të shuar ndjesinë e ankthit të mëngjesit nuk është e nevojshme që të stresoheni për të gjetur shkakun e këtij ankthi.

Gjëja kryesore është pranimi që keni një problem, dhe të ndryshoni sjelljen tuaj ndaj tij.

Ekspertët e psikologjisë pohojnë se një ankth i tillë nuk duhet luftuar, pasi mund të përkeqësohet duke shkaktuar kriza paniku.

Thelbi është qetësimi dhe reflektimi rreth problemeve që ju vërshojnë në mendje.

Një sjellje e tillë arrin të normalizojë reagimin e organizmit.

Duke qenë se truri fillon dhe dërgon sinjale qetësuese, trupi nuk është në gjendje alarmi dhe kështu kriza e ankthit kalon.

Por nëse kriza të tilla janë kronike, AgroWeb.org ju këshillon që të konsultoheni me mjekët përkatës. /Agroweb

ANKTHI - SI TA SHUANI NË MËNYRË NATYRALE

Dashur pa dashur, ankthi bëhet pjesë e jetës dhe përditshmërisë sonë.

Ankthi shoqërohet me ndjenja të frikshme që trondisin të gjithë organizmin deri në qelizë.

Ndonëse ndjesia e të qenit të pashpresë është e madhe, ka disa kura natyrale që ndihmojnë në shuarjen e ankthit.

Por nëse asnjë prej këtyre kurave nuk funksionon atëherë duhet të konsultoheni me një mjek specialist.

ÇFARË DUHET TË BËNI QË TË MBANI ANKTHIN NËN KONTROLL

Mos e teproni me alkolin

Një gotë ose dy tingëllojnë një alternativë e pranueshme për qetësimin e emocioneve.

Por nëse e teproni me alkolin, atëherë do të përballeni me një nivel më të lartë të ankthit.

Pirja e tepruar e alkolit ndikon ndjeshëm në punë e shtëpi por jo vetëm kaq.

Alkoli mund të nxisë probleme të tjera shëndetsore që shtojnë ankthin.

Rregulli i artë është jo më shumë se një pije alkolike, pra një gotë, në ditë për femrat dhe jo më shumë se 2 pije për meshkujt.

Aktiviteti fizik

Nuk është nevoja të stërviteni si për një maratonë.

Mjafton një ecje prej 10 minutash ose një aktivitet fizik për 45 minuta.

Secila prej këtyre alternativave do t'ju bëjë të ndiheni më mirë, njësoj si aspirina shuan dhimbjen e kokës.

Nëse kryeni një aktivitet të rregullt fizik të paktën 3 herë në javë, do të vini re që krizat e ankthit do të pakësohen.

Kopshtaria

Sipas ekspertëve të AgroWeb.org, kontakti me natyrën dhe në veçanti përkujdesja për bimët dhe lulet është një kurë që funksionon.

Kopshtaria është një aktivitet stimulues për trurin.

Nëpërmjet këtij aktiviteti do të ndiheni më mirë nga ana emocionale.

Për më tepër, ju do të kaloni më shumë kohë jashtë ambienteve të mbyllura.

Terapia e aromave

Aroma si ajo e lavandës, kamomilit dhe trëndafilut ju vijnë



Kontakti me natyrën dhe në veçanti përkujdesja për bimët dhe lulet është një kurë që funksionon. Foto: Flickr

në ndihmë.

Këto aroma mund t'i gjeni në formën e vajrave esencialë të cilat mund t'i nuhasni ose të fërkoni zona të trupit, kryesisht qafën.

Ekspertët mendojnë se këto aroma dërgojnë mesazhe kimike në tru të cilat ndikojnë për mirë tek humori dhe emocionet.

Gjumi

Gjumi furnizon trurin me energji

dhe përmirëson humorin dhe përqëndrimin.

Nga të dhënat e AgroWeb.org, nëse flini mjaftueshëm do të jeni më pak të prekur nga ankthi.

Kujdesuni që të flini të paktën 7 deri në 9 orë në ditë.

Përpikuni t'i përmbaheni një orari të caktuar gjumi dhe zgjimi.

Dhoma e gjumit duhet të jetë e freskët, në errësirë dhe pa zhurma.

Aktiviteti fizik përmirëson

gjumin, për sa kohë ushtroheni në mëngjes ose pasdite.

Mbani shënime

Përpikuni të identifikoni gjërat që nxisin ankthit, siç mund të jetë familja, puna, shkolla, kafeina apo uria.

Shkruani atë që mendoni se nxit ankthit dhe do të dini ta menaxhoni më mirë krizën e ardhshme. /Agroweb

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Kosova mbyll kualifikimet me humbje

"Dardanët" i mbyllën kualifikimet për Kampionatin Evropian "Euro 2020" me humbje. Kombëtarja e fuqishme botërore, Anglia, shënoi fitore me rezultat të thellë 0-4 në "Fadil Vokrri" kundër Kosovës. Kjo ishte humbja e parë e Kosovës në këto kualifikime dhe e para në stadiumin "Fadil Vokrri". Futbollistët e Bernard Challandesit në këto kualifikime grumbulluan 11 pikë dhe përfunduan në pozitën e tretë në Grupin A



STADIUMI "FADIL VOKRRI"

Golashënues: Winks, Kane, Rashford, Mount
Shikues: rreth 13 mijë
Gjyqtarë: Pawel Gil (Poloni)
Kartonë të verdhë: Kollolli
Kosova: Muriq, Vojvoda, Rrahmani, Aliti, Kollolli, Berisha (Halimi), Dresheviq, Hadergjonaj (Zhegrova), Celina, Rashica, Nuhii (Rashani).
Anglia: Pope, Arnold (Tomori), Maguire, Mings, Chilwell, Rice, Winks, Hudson-Odoi (Rashford), Sterling, Chamberlain (Mount), Kane.

portieri Muriq. Në minutën e 23-të gjuajtja e Rrahmanit bllokohet, kurse goditja e Rashicës ishte e lehtë për portierin Nick Pope. Pas gjysmë ore lojë edhe Callum Hudson-Odoi i mysafirëve provon, por pa ndonjë rezultat. Në minutën e 32-të Kosova e bëri gabimin e parë në mbrojtje dhe këtë e shfrytëzoi për mrekulli anëtari i Tottenham Hotspurit, Harry Winks, që doli përballë portierit Muriq dhe shënoi për 0-1. Në fund të pjesës së parë Valon Berisha provon që ta barazojë rezultatit por, pa sukses. Berisha dhe Rrahmani provojnë në pjesën e dytë ta barazojnë rezultatit, por nuk arritën që rastet që t'i shënojnë në gol. Anglia vazhdoi dominimin edhe në minutën e 62-të. Gjuajtjen e Rashfordit e ndali Muriqi, kurse gjuajtja e Kanes përfundoi në shtyllë. "Dardanët" patën edhe dy raste për të shënuar, por gjuajtja e Hadergjonajt u ndal pa problem nga portieri mysafir dhe gjuajtjen e Rashicës e bllokoi Declan Rice.

Në minutën e 79 Anglia shënoi edhe golin e dytë. Harry Kane e shfrytëzoi një gabim të Fidan Halitit dhe e dërgoi topin në rrjetën e portierit Muriq. Katër minuta më vonë zëvendësuesi Marcus Rashford e realizoi golin e tretë për "Tre Luanët", e golin e katërt e realizoi ylli i Chelseat, Mason Mount, i cili shfrytëzoi rrëshqitjen e Dresheviqit për ta vulosur rezultatit final 0-4. Trajneri i Anglisë, Gareth Southgate, pas ndeshjes është shprehur i kënaqur me fitoren e arritur ndaj Kosovës (0-4), por ai ka bërë me dije se asnjëherë nuk ka përjetuar atmosferë më të mirë se në stadiumin "Fadil Vokrri". "Kosova na e bëri të vështirë lojën, posaçërisht në pjesën e parë. Ishte e vështirë të luajmë nën presion, por shënuam një gol të bukur dhe



e hapëm lojën. Në 70 minuta është dashur ta mbajmë presionin. Atmosfera ishte e mrekullueshme. Nuk kam përjetuar kurrë atmosferë më të mirë se në Kosovë", ka thënë Southgate, duke shtuar: "Ne ju urojmë fat dhe ju falënderojmë për këtë pritje. Unë mendoj se gjithë skuadra e vlerëson këtë mikpritje. Keni ndeshje të mira në dy vjetët e fundit, por përvoja e ndeshjes në Pragë dhe ajo që ka përfutur Kosova do t'ju ndihmojnë shumë".

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 17 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll i mbylli me humbje kualifikimet për Kampionatin Evropian "Euro 2020" pasi u mposhtë nga Anglia me rezultat 0-4. Kjo është humbja e parë e "dardanëve" në këto kualifikime, por edhe në stadiumin "Fadil Vokrri". Pas kësaj humbje trajneri i Kosovës, Bernard Challandes, ka thënë se është i zhgënjyer me rezultatit e kësaj ndeshje. Strategu zviceran vlerësoi

lart efikasitetin e anglezëve përballë portës së "dardanëve". "Jam i zhgënjyer për rezultatit, kam parë gjëra të mira në këtë ndeshje. Kemi parë vetëm një gjë, ka qenë një nivel i lartë i efikasitetit të anglezëve, me një rast shënojnë gol. Kemi pasur disa mundësi, por nuk ishim të mirë në pasimin e fundit. Jam i zhgënjyer, por mund të nxjerrim diçka pozitive nga kjo ndeshje. Në fund të ndeshjes ishim paksa të lodhur. Patëm një javë shumë intensive, derisa Anglia ka luksin të bëjë shumë zëvendësime. Mbrojtja na la keq

në minutën e fundit. Nuk mund të bëjmë gabime si këto. Skuadra luajti një ndeshje të mirë, por kur e shikojmë në fund, rezultati është 4-0. Por ju e dini, kundërshtarë ishte Anglia", ka thënë Challandes. Në minutën e parë të ndeshjes, Florent Hadergjonaj gjuan plogësht në drejtim të portës së anglezëve, kurse pas katër minutave erdhi kundërpërgjigja e mysafirëve, por gjuajtjet e Harry Kanes dhe Harry Maguiret u bllokuan nga futbollistët e Kosovës. Në minutën e shtatë Kosova u mundua të gjejë golin e parë, por gjuajtja e sulmuesit Nuhii me kokë ishte e lehtë për portierin mysafir. Më pas Anglia provon dy herë ta realizojë golin e parë, por i pakalueshëm ishte



Hasani: Mund të fitojmë medalje në 'Tokyo 2020'

PRISHTINË, 17 NËNTOR - Kryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), Besim Hasani, për "KosovaPress" ka folur për 19 sportistët e zgjedhur për Lojërat Olimpikë "Tokyo 2020". Ai ka thënë se të gjithë sportistët që kanë arritur normën vijnë nga xhudoja, por presin edhe disa të tjerë nga karateja dhe boksi. "19 sportistët janë sportistë të Komitetit Olimpik të Kosovës, sportistët më të mirë në një periudhë të caktuar kohore, që ata në vijim t'i tregojnë rezultatet të cilat i dërgojnë drejt fitimit të normës olimpikë, respektivisht për mirësimin të performancës së tyre në vijim. Deri më tash i kemi 19 sportistë, pesë norma olimpikë, të gjitha vijnë nga xhudoja dhe pres-

im që të kemi diçka edhe nga karateja dhe boksi, por mund të na befasonjë edhe ndonjë sport tjetër", ka thënë Hasani, i cili ka shtuar se të gjithë sportistët që luajnë kanë gjasa për t'u rikthyer në 'shtëpi' me medalje. "Ata që realisht e arrijnë normën olimpikë nënkupton që janë në mesin e 14-18 më të mirëve në botë, që me një fitore hyjnë në mesin e tetëve, ndërsa fitorja tjetër i afron te medalja dhe nga të gjithë kemi pritshmëri që nëse janë në normë olimpikë, gjasat i kanë reale për të fituar medalje, por konkurrenca është e jashtëzakonshme në tërë botën", ka shtuar ai. Në fund kryetari i KOK-ut foli edhe për disiplinën e reja që kanë mundësi për ta fituar pjesëmarr-



rjen në lojërat olimpikë. "Në lojërat olimpikë udhëtojnë vetëm ata që arrijnë normën olimpikë dhe janë disa të cilët janë afër normave olimpikë. Sidoqoftë, ne i

inkurajomë të punojnë sa më shumë që është e mundur, në mënyrë që ose ta arrijnë normën olimpikë ose të ftohën për pjesëmarrje", ka përfunduar Hasani.

LISTA E 19 SPORTISTËVE

		DOLLARË NË MUAJ
Majinda Kelmendi	(xhudo)	1000
Nora Gjakova	(xhudo)	700
Herolind Nishevc	(karate)	600
Distria Krasniqi	(xhudo)	500
Donjeta Sadiku	(boks)	500
Orges Arifi	(karate)	350
Alvin Karaqi	(karate)	350
Akil Gjakova	(xhudo)	350
Loriana Kuka	(xhudo)	250
Musa Hajdari	(atletikë)	250
Astrit Kryeziu	(atletikë)	250
Vijona Kryeziu	(atletikë)	250
Urata Rama	(shenjëtari)	250
Dasar Xhambazi	(not)	250
Flaka Pruthi-Fjorda Shabani	(not)	250
Atdhe Luzhnica	(shigjetari)	250
Edon Shala	(mundje)	250
Fortesa Orana	(karate)	250
Drilon Ibrahim	(shenjëtari)	250

Besa regjistron fitoren e nëntë radhazi

PEJË, 17 NËNTOR - Kampionia aktuale, Besa Famgas, e ka fituar edhe një derbi në Superligën e Kosovës në hendboll. Skuadra pejane e ka mundur Kastriotin e Ferizajt me rezultat 45:33. Që në pjesën e parë vendësit krijuan epërsi bindëse (22:13). Besa ka

shënuar fitoren e nëntë radhazi dhe udhëheq në tabelë me 18 pikë, dy më tepër se Prishtina. Tahirukaj ishte më efikas te Besa me 12 gola. Shtatë gola i shënoi Gjuka. Te Kastrioti, Sylja shënoi dhjetë herë. Mustafa realizoi gjashtë gola. Kastrioti

është i katërti me 12 pikë. Në tri ndeshje të tjera të javës së nëntë të Superligës së Kosovës në hendboll (meshkujt), Llapi fitoi bindshëm ndaj Dritës në Podujevë, ndërsa Vëllaznimi arkëtoi dy pikë në Drenas, duke e mposhtur Drenicën me rezul-

tat 40:30. Ndeshja më interesante është luajtur në Prizren në mes të Prizrenit e Vushtrrisë. Ndeshja përfundoi baras, 31:31. Pas pjesës së parë vushtrriasit kishin dy gola epërsi (16:14), por në të dytën vendësit arritën te pika e madhe.



Prishtina mposhti Ponte Prizrenin, Rahoveci bindës ndaj Feronikelit

PRISHTINË, 17 NËNTOR - KB Sigal Prishtina e ka mposhtur Ponte Prizrenin me rezultat 72:88 (17:19, 19:17, 15:26, 21:26), në ndeshjen e fundit të xhiros së 11-të të Superligës së Kosovës në basketboll. Takimi ka qenë shumë interesant, ku çerekun e parë fitojnë mysafirët 17:19, derisa vendësit u kundërpërgjigjën në periodën e dytë që e fituan 19:17, për të shkuar në pushim me rezultat 36:36. Megjithatë, në pjesën e dytë prishtinasit ishin më të mirë. Dallimi u bë në periudhën e tretë, që e fitojnë bardhekaltrit 15:26 dhe atë të fundit 21:26, për të fituar në fund 72:88. Malcom Canada shënoi 20 pikë për Ponte Prizrenin, derisa Urim Zenelaj kishte 15 pikë dhe 23 kërcime. Te Prishtina më të mirët ishin Fahro Alihoxhiq me 26 pikë e 14 kërcime, Jonathan Wade me 19 pikë, 6 kërcime dhe Mikailë Tmusiq me 17 pikë, 4 kërcime dhe 7 asistime. Prishtina tani ka gjashtë fitore dhe tri humbje, kurse Prizreni pesë fitore dhe pesë humbje. Ndërkohë Rahoveci ka



shënuar fitore në Superligë, duke e mundur Feronikelin me rezultat 87:61 (23:17, 29:20, 20:16, 15:8), në kuadër të xhiros së 11-të. Vendësit kanë dominuar nga fillimi deri në fund për të shënuar fitore të merituar dhe duke e mposhtur skuadrën e vetme që i kishte mundur në këtë edicion. "Vreshtarët" e fillojnë ndeshjen më mirë dhe fitojnë çerekun e parë 23:17, derisa me lojë vazhdojnë edhe në periodën e dytë që e

fitojnë 29:20. Më të mirë ishin edhe në periodën e tretë 20:16 dhe atë të katërt 15:8, duke triumfuar në fund me rezultat 87:61. Te Rahoveci u dalluan Joshua McFolley me 21 pikë, 6 kërcime e 3 asistime, Javis Howard me 17 pikë e 10 kërcime, si dhe Jure Gunjina me 14 pikë e 10 kërcime. Ndërkohë, te Feronikeli më të mirët në parket ishin Arti Hajdari dhe Brandon Scott me nga 17 pikë.

Houstoni mposhti Minnesotan

MINNESOTA, 17 NËNTOR - Plot ndeshje të zhvilluara në NBA e mes rezultateve të ekzagjeruara dhe betejave në nivelit më të lartë, spikatin sërish emrat e mëdhenj, si James Harden e Luka Donçiq. Vazhdon të shënojë me ritëm të çmendur James Hardeni, që në fitoren 105-125 të Houston Rocketsit në parketin e Minesota Timberwolvesit realizoi plot 49 pikë, dha 6 asistime dhe kontrolloi 5 topa poshtë koshit. "Mjekroshi" i NBA-s është thjesht i një planeti tjetër, pasi kur është në formë, askush nuk mund t'i bëjë ballë. 27 pikë dhe 15 "rebounde" ishin statistikat e Townsit për vendësit, por që nuk mund ta kthenin rrjedhën e lojës. Kampioni e NBA-s, Toronto Raptors, u dorëzua në fushën e Dallas Mavericksit me rezultatin 110-102. I zakonshmi Luka Donçiq rrëmbeu skenën në "American Airlines Center" të Dallasit me 26 pikë, 15 "rebounde" e 7 asistime, duke



REZULTATET

Chicago B. - Brooklyn N.	111-117
Indiana P. - Milwaukee B.	83-102
New York K. - Charlotte H.	102-103
Miami H. - New Orleans P.	109-94
Minnesota T. - Houston R.	105-125
Dallas M. - Toronto R.	110-102
San Antonio S. - Portland Trail B.	116-121
LA Clippers - Atlanta H.	150-101

qenë frymëzuesi i këtij suksesi të Mavericksit, i 7-ti në këtë fillim sezoni. Gjithçka e lehtë për Milwaukee Bucksin, që u kthye me fitore nga Indiana, pas suksesit 83-102 ndaj Pacersit. Provë "normale" për Giannis Antetokounmpo, që e mbylli takimin me 26 pikë dhe 13 "rebounde".

SHKURT

Arsenali mendon ta rikthejë Xhakën në Monchengladbach

Skuadra e Arsenalit do ta ofrojë Granit Xhakën në shkëmbim të mesfushorit Denis Zakaria. Për mesfushorin shqiptar të Zvicrës kjo do të nënkuptonte rikthim te klubi i vjetër, Borussia Monchengladbach. Xhakës iu mor shiriti i kapitenit këtë muaj pas zënkës me tifozët e vet muajin e kaluar dhe thuhet se mesfushori nuk do të luajë më për klubin nga Londra Veriore. Ai nuk ishte pjesë e skuadrës së Unai Emery në asnjërin prej disa ndeshjeve pasi e humbi shiritin e kapitenit, por luajti me Zvicrën në ndeshjet kualifikuese për Euro 2020, ku edhe bëri komente thumbuese për tifozët e Arsenalit. Mediat britanike shkruajnë se Arsenalit i intereson Zakaria, mesfushori zviceran që po shkëlqen me klubin gjerman këtë sezon, i cili është lider i Bundesligës momentalisht. Marrëveshja do të varet nga Monchengladbach, pasi mund të kërkojë vetëm para për 22-vjeçarin dhe jo shkëmbim lojtarësh. Xhaka i thumboi tifozët e vet përsëri pas një ndeshjeje me Zvicrën, duke shkruar në rrjetet sociale: "Lumturi quajmë kur je i kënaqur me veten dhe nuk të nevojitet konfirmimi i të tjerëve".

Abidali: Barça gjithmonë e ka në opsjon Neymarin

Neymari ishte shumë afër rikthimit në Barcelonë në verën e shkuar, por marrëveshja dështoi për shkak të kërkesave që kishte PSG-ja. Sulmuesi brazilian e ka shfaqur hapur dëshirën që ka për t'u rikthyer te katalanasit, aty ku u largua para dy vjetësh. Për një aftrim të mundshëm në të ardhmen të sulmuesit te Barcelona ka folur edhe drejtori sportiv i këtyre të fundit, Erik Abidal. "Ai është një lojtar shumë i mirë dhe ka filozofinë e futbollit që ka edhe Barcelona. Gjithmonë do të jetë një opsjon për ne. Përtej kësaj ne duhet të marrim disa vendime për sa iu përket çështjeve financiare. Disa prej tyre janë të realizueshme e disa të tjera jo", ka thënë Abidali.

Unitedi, gati ta bëjë 'çmendurinë' për Sanchon dhe Haalandin

Manchester Unitedi duket se ka ndërmend të bëjë një çmenduri të vërtetë në afatin kalimtar të janarit. Sipas raportimeve të fundit nga "Mirror", drejtuesit nga "Old Trafford" do të tentojnë blerjet e Jadon Sancho dhe Erling Braut Haaland. Për ta arritur transferimin e këtyre dy lojtarëve, Unitedi ka vendosur në dispozicion plot 185 milionë sterlina, ku 100 milionë do të ofrohen në pjatë për Dortmundin, ndërsa pjesa tjetër për Salzburgun.

Rakitiqi, në mes të Milanit dhe Juves

Mesfushori i Barcelonës, Ivan Rakitiqi, raportohet se po konsideron kalimin te Milani vitin e ardhshëm. Sipas "Calciomercatos", mesfushori pret që kërkesa e tij për pagë 7.8 milionë euro për sezon të pranohet nga klubi italian, edhe pse kjo konsiderohet e vështirë. Interesim për të ka shfaqur edhe Juventus. Barcelona kërkon rreth 35 milionë euro për kroatin, i cili sivjet është paraqitur vetëm në shtatë ndeshje në La Ligë.

Marquezi e mbylli me fitore Botërorin në MotoGP

Marc Marquez e mbylli në mënyrën më të mirë të mundshme Botërorin e MotoGP 2019. Piloti spanjoll i Hondas e fitoi Çmimin e Madh të Valencias, në garën e fundit të sezonit, duke e mbyllur si kampion bote me dallim të theksuar nga ndjekësi më i afërt, Andrea Dovizioso. Në Valencia Marquez e kaloi vijën e finishit duke lënë pas Fabio Quartararon e Jack Millerit. Vendi i katërt ishte për Andrea Dovizioso, ndërsa Valentino Rossi e mbylli në vendin e tetë. Dritëhera për Zarcon që, pasi u rrëzua, u shtyp nga motori KTM i Iker Lecuonas, fatmirësisht pa pasoja serioze. E përfundon në vendin e 13 garën e fundit të karrierës së tij në MotoGP Jorge Lorenzo, që pak ditë më parë njoftoi se do të tërhiqet nga Formula 1.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE
REGIONAL WASTE COMPANY
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA

Tel. +381(0)390/321 588
+381(0)390/324 034
www.cabrati.com
e-mail: info@cabrati.com
Gjakovë - Gjakova

K.R.M. "ÇABRATI"

KOMPANIA RAJONALE E MBETURINAVE "ÇABRATI" SH.A. GJAKOVË, duke u bazuar në Nenin 4 paragrafi 1 pika 6 e UA. (MPMS) Nr. 07/2017 dhe Vendimit Nr. 1686 të datës 07.11.2019 të Kryeshefit Ekzekutiv, vendosi që me datë 18.11.2019 të shpallet konkursi publik:

Konkurs

Për 5 pozita dhe atë:

- I. **1/një/ Menaxher i Shitjes** me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një/ vjeçare), me mundësi vazhdimi.

Kushtet:

- Të posedojnë aftësi fizike dhe shëndetësore për punë me ngarkesë fizike dhe zbatim të urdhëresave të gjitha llojet e punëve Menaxheriale në sektorin e Shitjes, në terren, vende dhe të gjitha llojet e punëve nga veprimtaria primare dhe skondarë që ja përcakton punëdhënësi,
- Preferohet të ketë më së paku shkollim superior-Bachelor,
- Duhet të posedoi patentë shoferi me së paku "B" kategori,
- Të mos jetë dënuar nga Gjykata,
- Për punën e vetë i përgjigjet Zyrtarit Kryesor Financiar dhe Thesarit dhe Kryeshefit Ekzekutiv.

Kushtet e veçanta:

Punëtori 6/gjashtë/ muajt e parë do të jetë në punë provuese dhe varësisht nga performanca e tij do ti vazhdohet apo ndërpritet kontrata e punës.

Dokumentet e nevojshme:

1. Kërkesa dhe CV -ja,
2. Dëshminë-Diplomën mbi kryerjen e shkollimit superior fakultetin Ekonomik 4/katër/ vjeçar apo me sistem Bolonjës 3+2,
3. Përvoja e punës menaxhuese 3 vjeçare,
4. Patentë Shoferin së paku me "B" kategori,
5. Dëshminë nga Gjykata se nuk jeni nën hetime (më e re se 6 muaj) .

- II. **1/një/ Zyrtar i Depos** me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një/ vjeçare), me mundësi vazhdimi,

Kushtet:

- Të posedojnë aftësi fizike dhe shëndetësore për punë me ngarkesë fizike dhe zbatim të urdhëresave të gjitha llojeve të punëve në depon e ndërmarrjes dhe në terren, dhe të zbatoi urdhëresat që ja përcakton punëdhënësi,
- Preferohet të ketë më së paku shkollim të mesëm,
- Duhet të posedoi patentë shoferi me së paku "B" kategori,
- Dëshmine nga Gjykata që nuk jeni nën hetime (më e re se 6 muaj) .
- Për punën e vetë i përgjigjet Zyrtarit Kryesor Financiar dhe Thesarit.

Kushtet e veçanta:

Punëtori 6/gjashtë/ muajt e parë do të jetë në punë provuese dhe varësisht nga performanca e tij do ti vazhdohet apo ndërpritet kontrata e punës.

Dokumentet e nevojshme:

- Kërkesa dhe CV -ja.
- Dëshminë-Diplomën mbi kryerjen e shkollimit të mesëm.
- Përvoja e punës mbi 1 /një/ vit.
- Patentë Shoferin së paku me "B" kategori,
- Dëshminë nga Gjykata që nuk jeni nën hetime (më e re se 6 muaj) .

- III. **1/një/ Zyrtar/e për Informim** me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1 /një/ vjeçare), me mundësi vazhdimi,

IV.

Kushtet:

- Të posedojnë aftësi të mira shëndetësore për punë me ngarkesë në zbatim të urdhëresave të gjitha llojeve të punëve të informimit për nevojat e ndërmarrjes dhe në terren, dhe të zbatoi urdhëresat që ja përcakton punëdhënësi,
- Kandidati duhet të posedojë diplome universitare në drejtimin: gjuhë apo letërsi shqipe. Komunikim masiv apo Gazetari.
- Te posedojë përvojë pune profesionale mbi 1 (një) vjeçare.
- Duhet të posedoi aftësi të mira komunikuese, në të dy gjuhët zyrtare, preferohet njohja e gjuhës angleze.
- Duhet të ketë njohuri të mira të punës me kompjuter Word, Excele, dhe Power Point
- Dëshmine nga Gjykata që nuk jeni nën hetime (më e re se 6 muaj).
- Për punën e vetë i përgjigjet Kryeshefit ekzekutiv apo personit që e autorizon KE.

Kushtet e veçanta:

Punëtori 6/gjashtë/ muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij/saj do ti vazhdohet apo ndërpritet kontrata e punës.

Dokumentet e nevojshme:

- Kërkesa dhe CV -ja,
- Dëshminë-Diplomën mbi kryerjen e fakultetit nga drejtimet e kërkuara të nivelit bachelor,
- Përvoja e punës mbi 1 vit nga puna profesionale,
- Dëshmite për njohurit e gjuhëve të huaja (angleze),
- Preferohet të ketë njohuri të mira të punës me kompjuter Word, Excel, dhe Power Point,
- Dëshminë nga Gjykata që nuk jeni nën hetime (më e re se 6 muaj).

- V. **1/një/ Mbikëqyrës i fshesëtarëve** me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një/ vjeçare), me mundësi vazhdimi,

Kushtet:

- Të posedojnë aftësi fizike dhe shëndetësore për punë me ngarkesë fizike dhe zbatim të urdhëresave të gjitha llojeve të punëve, menaxhimit të punës në grup në terren, dhe të zbatoi urdhëresat që ja përcakton punëdhënësi,
- Preferohet të ketë më së paku shkollim të mesëm,
- Duhet të posedoi patentë shoferi me së paku "B" kategori,

- Dëshmine nga Gjykata që nuk jeni nën hetime (më e re se 6 muaj),
- Për punën e vetë i përgjigjet Menaxherit të Operativës.

Kushtet e veçanta:

Punëtori 6 /gjashtë/ muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do ti vazhdohet apo ndërpritet kontrata e punës.

Dokumentet e nevojshme:

- Kërkesa dhe CV -ja,
- Dëshminë-Diplomën mbi kryerjen e shkollimit të mesëm,
- Përvoja e punës mbi një vit për punë të ngjashme,
- Patentë Shoferin së paku me "B" kategori,
- Dëshminë nga Gjykata që nuk jeni nën hetime (më e re se 6 muaj).

- VI. **1/një/ Mbikëqyrës i punëve në Gjelbërim** me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1 /një/ vjeçare), me mundësi vazhdimi,

Kushtet:

- Të posedojnë aftësi fizike dhe shëndetësore për punë me ngarkesë fizike dhe zbatim të urdhëresave të gjitha llojeve të punëve, menaxhimit të punës në grup në terren, dhe të zbatoi urdhëresat që ja përcakton punëdhënësi,
- Preferohet të ketë më së paku shkollim të mesëm,
- Duhet të posedoi patentë shoferi me së paku "B" kategori,
- Dëshmine nga Gjykata që nuk jeni nën hetime (më e re se 6 muaj).
- Për punën e vetë i përgjigjet Menaxherit të Operativës.

Kushtet e veçanta:

Punëtori 6 /gjashtë/ muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do ti vazhdohet apo ndërpritet kontrata e punës.

Dokumentet e nevojshme:

- Kërkesa dhe CV -ja,
- Dëshminë-Diplomën mbi kryerjen e shkollimit të mesëm,
- Përvoja e punës mbi një vit për punë të ngjashme,
- Patentë Shoferin së paku me "B" kategori,
- Dëshminë nga Gjykata që nuk jeni nën hetime (më e re se 6 muaj).

Përshkrimin e tekstit të konkursit dhe detyrat e punës për pozitat e interesuar mund t'i gjeni në Web faqen e kompanisë www.cabrati.com.

Afati i paraqitjes së kërkesave është 15 ditë nga dita e publikimit, (nga data 18.11.2019 e deri me datë 02.12.2019 ora 16:00).

Kërkesën me dokumentacionin e kërkuara, kandidatet duhet t'i dorëzojnë në drejtorin e KRM."Çabrati" SH.A. në Gjakovë, Rr."Mazllom Lakuci" pn. (tek sekretaria- Udh. Burimeve Njerëzore). Dokumentet pa afat dhe të pakompletuara nuk do të merren për bazë. Pas kalimit të afatit të konkursit, kandidatet që plotësojnë kushtet i nënshtrohen procedurës së testit dhe intervistës.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A
Kosova Landfill Management Company J.S.C
Rr.Bekim Fehmiu 137, Lakrishte, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 600 551; 600 552
www.kmdk-ks.org

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A

Komisioni i Auditimit të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Republikën e Kosovës (KMDK SH.A), në mbledhjen e mbajtur me datë 18/09/2019, duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në bazë të nenit 21 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në bazë të nenit 26.6 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, si dhe në bazë Rregullores Nr. 01/2017 për Procedurat e Punësimit, Strukturën Organizative, Kategorizimin dhe Përshkrimin e Vendeve të Punës në KMDK SH.A ka vendosur të shpallë:

Shpallje e Konkursit Publik për pozitën:

1. Pozita: Zyrtar i Auditimit të Brendshëm KMDK SH.A (1 pozitë)

Vendi i punës: KMDK SH.A, Zyrat Qendrore Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përveç detyrave të parapara me Ligj, Statut dhe Kodin e Etikës.
- Përpilimi i procedurave të auditimit, gjegjësisht planit të brendshëm për të gjitha transaksionet e kompanisë konform objektivave të kontrollit të brendshëm, politikave dhe procedurave të kompanisë të bazuara në legjislacionin të aplikueshëm.
- Auditimi i planeve të investimeve dhe financave të kompanisë, planit vjetor të biznesit dhe buxhetin vjetor.
- Auditimi i pasqyrës vjetore të bilancit dhe deklaratat e fitimeve dhe humbjeve si dhe deklaratat financiare që kërkohen me ligj.
- Vlerësimi objektiv dhe shfrytëzimi efektiv i burimeve të Kompanisë dhënia e rekomandimeve adekuate për Komisionin e Auditimit dhe Menaxhmentin e Kompanisë.
- Verifikimi i përshtatshmërisë dhe funksionimit të rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë qëllim të garantojnë zbatimin e të gjitha ligjeve të aplikueshme në Kosovë nga Kompania gjatë veprimtarisë, dhe ti sigurojë Komisionit të Auditimit çfarëdo vërejtje ose sugjerime të cilat konsiderohen të nevojshme.
- Verifikimi i rregullt i përshtatshmërisë dhe funksionimit të rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë qëllim që të sigurojnë se librat dhe dokumentacioni i kompanisë, duke përfshirë dokumentacionin financiar, mbahen në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe me ligjin, si dhe përgatitja e rregullt e deklarativave vjetore financiare.
- Analiza sistematike e proceseve të biznesit dhe kontrolleve të ndërlidhura me to.
- Raportimi i rregullt para Komisionit të Auditimit dhe përmbushja e çfarëdo detyre tjetër të përcaktuar nga Komisioni i Auditimit.
- Udhëheqje dhe menaxhon organizimin e brendshëm të zyrës së auditimit.
- Udhëheqje dhe drejton të gjitha aktivitetet e auditimit të brendshëm.
- Për punën e tij/saj i përgjigjet Komisionit të Auditimit.

Kualifikimi:

- Të parapara me Ligj, Statut dhe Kontratë të Punës.
- Diplomë Universitare në fushën financiare, duke u ndërlidhur me trajnim dhe eksperiencë.
- Përvojë pune së paku 3 vjeçare e dëshmuar në menaxhim financiar dhe në përpilimin e raporteve financiare të jetë Auditor i Certifikuar
- Demonstrimi i aftësive të shkëlqyeshme të komunikimit dhe të bashkëpunimit me menaxhmentin dhe stafin e kompanisë.
- Demonstron pëlqimin me kërkesat nga Kodi i Etikës dhe praktikata e auditimit intern.
- Preferohet njohje e mirë e gjuhës angleze.

Informata të përgjithshme për kandidatë:

Përcaktimi i pagës për pozitën e shpallur bëhet në përputhje me aktet e brendshme të Kompanisë.

Procedura e konkurrimit:

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin aplikacionin përkatës, të shoqëruar nga një biografi personale (CV), nga një letër motivuese, dokumentacionin përkatës për përgatitjet shkollorë dhe për përvojën e kërkuar të punës duke ia bashkangjitur vërtetimin nga Gjykata kompetente se i njëjti nuk është nën hetime për vepra penale.

Forma e aplikacionit mund gjendet në Web-faqe (www.kmdk-ks.org) të KMDK-së.

Aplikacioni, me të gjitha dokumentet, duhet të dorëzohet në kopje fizike në zyrën e Administratës të KMDK-së, në adresën: Rr.Bekim Fehmiu 137, Lakrishtë afër shkollës Shtjefën Gjeçovi.

Afati për aplikim është 30 ditë nga dita e publikimit të Konkursit të Publik duke filluar nga data: 18.11.2019 deri me datën 17.12.2019 ora 16:00.

Email: info@kmdk-ks.org

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/giejpuneshpejte

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Arxhend Ahmetaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmgj "Gjon Buzuku" Prizren.

► Fadil Alija shpall te pavlefshme diplomën Shmllt "11 Marsi" Prizren.

► Sedat Mimari shpall te pavlefshme diplomën shmllt "11 Marsi" Prizren.

► Aziza Smaili shpall te pavlefshme diplomën shmllt "11 Marsi" Prizren.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtime i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

